

Aleksandra Filipović
Milica Matanović
Ana Perunović-Razhnatović

AVENTURA E MUZIKËS

1

MANUALI PËR
MËSUESE/MËSUES

Kultura muzikore për klasën
e parë të shkollës fillore



Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore
PODGORICË, 2026

Aleksandra Filipović

Milica Matanović

Ana Perunović-Razhnatović

AVENTURA E MUZIKËS 1

Kultura muzikore

për klasën e parë të shkollës fillore

MANUALI për

mësuese/mësues

Botuesi

Enti i Teksteve dhe i Mjeteve

Mësimore – PODGORICË

Për botuesin

Mr. Aleksandra Hajduković, drejtoreshë

Kryeredaktor

Mr. Radulle Novović

Redaktor përgjegjës

Llazo Leković

Redaktore e botimit

Bilana Miranović

Redaktor në gjuhën shqipe

Dimitrov Popović

Recensentë

Dr. Vesna Vučinić

Mr. Natasha Popović

Mr. Vera Marković

Fran Vulaj

Radmila Bajković

Përkthyes

Luigj Dedvukaj, arsimtar i lëndës

Korrektura

Luigj Dedvukaj

Ilustrimet

Maria Popović

Disenjoja dhe faqosja

Millena Llakićević

Faqosja

Marijana Simonović

Redaktore teknike

Dajana Vukčević



CIP – Каталогизација у публикацији
Национална библиотека Црне Горе, Цетиње

ISBN 978-86-303-2579-3

COBISS.CG-ID 36994052

Këshilli Kombëtar i Arsimit, me Vendimin nr. 05/3-01-119/24-5099/7 të datës 16. 7. 2024,
e ka miratuar këtë Manual për përdorim në shkollën fillore.

Copyright © Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2026

PËRMBAJTJA

Parathënie.....	6
Udhëzime metodike për realizimin e orës mësimore.....	8
Këngët e numërimit (lojërat muzikore).....	8
Hapat metodikë gjatë përpunimit të këngës së numërimit.....	9
Shembulli i përpunimit të këngës së numërimit (lojës muzikore).....	9
Hapat metodikë për përpunimin e këngës me anë të veshit.....	10
Vallet muzikore.....	11
Luajtja në instrumentet e instrumentariumit të Orfit.....	11
Dëgjim muzikor.....	12
Krijimi dhe kreativiteti.....	13
Mirë se erdhët fillestarë.....	14
 1. TINGUJT NA RRETHOJNË.....	16
Tingujt nga natyra.....	16
Eci peci pec.....	17
Tingujt nga qyteti.....	18
Gjithçka që dëgjon.....	19
 2. THESARET POPULLORE.....	21
Nën atë mal të gjelbër.....	21
Durmitori.....	22
Hidhu djal i ri.....	24
Lahuta.....	25
Cyle dyjare (bicula).....	26
Nina, zemra ime.....	27
Vjeli, vjeli rrushin.....	28
 3. RITMI I STINËVE TË VITIT.....	30
Vjeshta.....	30
Shiu.....	32
Kënga e dimrit.....	34
Viti i ri.....	36
Pranvera.....	37
Maçoku.....	38
Vera.....	40
Ditë me diell.....	42
Gaforrja.....	43

4. NJOHIM INSTRUMENTET.....	45
Piano.....	46
Trumbeta.....	47
Violina.....	47
5. MUZIKËN E NDJEJME.....	49
Babi.....	49
Muzika dhe ndjenjat 1.....	51
Muzika dhe ndjenjat 2.....	53
6. HAPËSIRA PËR DËGJIM TË MUZIKËS	54
Ditari-regjistri për dëgjim.....	55
Shfaqjet e klasës.....	56
Skenari për performancën-shfaqjen e klasës (mësim publik).....	57
Rekomandime për afrimin dhe punën me fëmijët me nevoja të veçanta, nevojat arsimore dhe fëmijët e talentuar.....	61
Aktivitete muzikore.....	63
Fëmijët me prirje muzikore.....	64
Aktivitete muzikore për punën me nxënësit që kanë prirje.....	65
LITERATURA.....	65

PARATHËNIE

Të nderuara mësuese dhe të nderuar mësues,

Kompleti i tekstit **Aventura e muzikës 1** përbëhet nga teksti mësimor dhe manuali për mësueset dhe mësuesit.

Duke përzgjedhur me kujdes pjesët muzikore, këngët origjinale të autorëve, këngët e numërimit -këngët lojë, vallëzimet e kërcimet, jemi përpjekur t'i paraqesim rezultatet e kurrikulës¹ në një mënyrë sa më interesante dhe të arritshme për nxënës e nxënës. Gjatë përgatitjes së tekstit, në radhë të parë kemi dashur që përmbajtjen e tij ta paraqesim në mënyrë argëtuese dhe edukative, përmes pyetjeve, labirinteve dhe plotësimeve, dhe kështu t'i paraqesim nxënësit botën magjike të muzikës, të këngëve dhe lojërave. Për ta ky është një fillim i ri dhe një mënyrë për të fituar njohuri, ndërsa për mësueset/mësuesit² një mundësi, që në fillim të shoqërimit dhe mësimi nxënësit ta duan muzikën.

Në manual janë të shtjelluar në detaj skenarët për çdo orë mësimore, me përfundime të dhëna dhe aktivitetet për realizimin që përcjell rezultatet e të nxënit. Këngët dhe shembujt muzikorë, do të mund t'i përdorni duke skanuar kodin QR, i cili do të gjendet i bashkëngjitur për këngë, lojëra dhe material në tekstin mësimor, ndërsa në manual së bashku me kodin QR do të keni edhe këngët e shënuara me nota muzikore. Ne e konsiderojmë kodin QR si risinë më të rëndësishme në kompletin e tekstit mësimor. Gjithashtu, një segment të rëndësishëm paraqet edhe numri i madh këngëve autoriale. Këngët dhe lojërat muzikore (këngët e numërimit) janë ndryshe, por që sjellin freski të caktuar me përmbajtjen dhe tematikën e tyre dhe ato janë të ndërlidhura me temat e lëndëve të tjera mësimore që janë në klasë të parë.

Me meloditë dhe ritmin e tyre, ato tregojnë në mënyrë interesante ndryshimet në natyrë (kapitulli "*Ritmi i stinëve të vitit*"). Këngët e numërimit për kafshët, instrumente dhe dukuritë në natyrë, në mënyrë humoristike dhe interesante lidhin tema nga jeta e përditshme me muzikë dhe ritmogram (*Macet, Lahuta, Akrepi*).

Në kuptimin konceptual, vendosëm të nisim nga tingulli, toni dhe heshtja, si pikënisje dhe bazë për takimin e parë të nxënësve me lëndën Kultura muzikore. Viojnë kapitujt e mëposhtëm që titullohen "Thesaret popullore" (këngët popullore dhe instrumentet), "Ritmi i stinëve të vitit" (këngët, lojërat dhe këngët e numërimit që kanë lidhshmëri tematike me stinët), "Njohim instrumentet", "Muzikën e ndjejmë" dhe "Dëgjimorja" hapësira për dëgjim të muzikës. Në

1 Programi i lëndës KULTURA MUZIKORE (2017)

2 Në vazhdim të manualit, për të shmangur mbingarkimin shtesë të tekstit, herë pas here përdorni termin "mësues" dhe ai do t'u referohet të dy gjinive.

kapitullin “Njohim instrumentet” është paraparë përpunimi i tri instrumenteve artistike – i trumbetës, violinës dhe pianos. Kapitujt “Muzikën e ndjejmë” dhe “Dëgjimorja” përpunojnë dëgjimin e muzikës në mënyra të ndryshme – në të parën, dëgjojmë muzikë dhe mendojmë se si ajo ndikon në emocione, ndërsa në të dytën, çfarë mund të përshkruajë muzika.

Udhëzimet metodologjike në manual ndjekin parimet bazë të metodologjisë së mësimdhënies së kulturës muzikore dhe janë të karakterit të përgjithshëm, dhe shtjellohen hollësisht në kuadër të njësive mësimore. Vini re se rendi i temave mësimore në tekstin mësimor dhe në manual nuk e ndjek Planin e punës, por vetë mësueset/it do të zgjedhin dhe përcaktojnë kohën e realizimit të temave të caktuara.

Sipas manualit është paraparë një orë për përpunimin e temave, por në varësi të aftësitë së nxënësit, interesimit dhe arritjes, dhe sipas vlerësimit tuaj ato mund të përpunohen edhe në numër më të madh orësh.

Veçanërisht veçojmë pjesën nën emrin “Shfaqja e klasës” e cila u dha si shtesë në manual. Një numër i caktuar orësh janë paraparë me program si pjesë e lirë dhe përfshin rreth 20%. Për atë pjesë, ne projektuam disa programe/shfaqje të cilat tematikisht korrespondojnë me shënimin e datave të rëndësishme. Në të njëjtën kohë, me këtë arrihet edhe bashkëpunimi me bashkësinë lokale- komunitetin, i cili është shumë i rëndësishëm për realizimin e tërë të programit lëndor.

Ju urojmë punë të mbarë!

Autoret

UDHËZIME METODIKE PËR REALIZIMIN E ORËS MËSIMORE

Këngët e numërimit (lojërat muzikore)

Fillimi i punës, gjegjësisht mësimit të muzikës në procesin mësimor në klasat e para duhet të kuptohet dhe të realizohet përmes këngëve të numërimit. Përse këngët e numërimit?

Fëmija, kontaktin e parë me ritmin e ka në moshën më të hershme falë këngëve të ndryshme të numërimit, të cilat (më shpesh) i dëgjon dhe i mëson për herë të parë në familje. Gjithashtu, impulsi natyror dhe bazë të njeriu është lëvizja me ritmin. Për këtë arsye, kënga e numërimit është një lloj shqiptimi ose recitimi ritmik i tekstit, të cilin fëmijët e pranojnë me dëshirë dhe shpejtësi më të madhe, dhe e mbajnë në mend. Këtë formë të shprehurit, fëmijët gjatë rritjes së mëtejme e përdorin si një formë të numërimit dhe rinumërimit, të cilën më vonë, për shembull, mund ta përdorin si korrelacion me matematikën dhe edukimin fizik. Fëmijët i duan këto këngë të numërimit - lojëra muzikore, sepse ato përfaqësojnë hyrjen në ndonjë lojë tjetër, kurse ritmika e tyre, e ndonjëherë jokoherenca dhe pakuptimësia e tekstit, fëmijët i shtyn që t'i mbajnë mend më shpejt ato.

Këngët e numërimit kanë vlera të shumta për fëmijë:

- zhvillojnë ndjenjën për ritmin, tempin dhe dinamikën (ngjyrimin),
- zhvillojnë të folurit, shqiptimin dhe ndjenjën e rimës,
- zhvillojnë kreativitetin, imagjinatën dhe kujtesën,
- zhvillojnë aftësitë motorike, koordinimin dhe ekuilibrin.

Përpunimi i këngës së numërimit kryhet përmes aktiviteteve të ndryshme:

- mësimi dhe përsëritja e tekstit të këngëve të numërimit,
- interpretimi i këngëve të numërimit me shoqërim të ndonjë instrumenti ose burimeve të tjera tingullore,
- interpretimi i këngëve të numërimit me lëvizje të trupit ose me rekuizita,
- vallëzimi/kërcimi i valleve që përfshijnë këngët e numërimit si hyrje ose pjesë të valles.

Elementi më i rëndësishëm i këngës së numërimit është ritmi, ndaj duhet t'i kushtoni vëmendjen më të madhe. Për këtë arsye, teksti mësimor përmban këngë të numërimit në të cilat nxënësit mësojnë figura të ndryshme ritmike, si dhe për tema të ndryshme nga natyra, matematika, gjuha etj.

Ata nëpërmjet këngëve të numërimit me pavetëdiqe mësojnë kohëzgjatjen e notave, pjesët e theksuara dhe të patheksuara të taktit (masës), llojin e taktit, e ndonjëherë figura ritmike shumë të vështira dhe të përbëra-komplekse, ashtu që këngën e numërimit duhet ta ruani dhe përdorni si një element të domosdoshëm të punës gjatë përpunimit të kohëzgjatjeve ritmike edhe në klasat e larta.

Hapat metodikë gjatë përpunimit të këngës së numërimit

Gjatë përpunimit të këngës së numërimit, mësuesi fillimisht duhet përmes tregimit t'i udhëheqë nxënësit dhe nxënëset në temën e këngëve të numërimit. Ai mund të bëjë një ilustrim të tregimit që përputhet me temën e këngës së numërimit.

Mësuesi do të përsërisë disa herë, saktësisht, në mënyrë të artikuluar dhe me theks të duhur shqiptimin e këngës së numërimit. Pastaj, ai do të përsërisë disa pjesë të caktuara disa herë dhe do të kërkojë nxënësve të përsërisin me të. Pas përsëritjes ata vetë do të thonë-shqiptojnë këngën e numërimit. Derisa të zgjasë kjo pjesë e përpunimit, mësuesi godet pëllëmbën e tij në pëllëmbë dhe jep ritëm të qartë duke trokitur.

Kur kënga e numërimit të përvetësohet pjesë-pjesë, ekzekutohet e tëra, kurse nxënësit/et do të mund ta realizojnë individualisht, në çift ose në grup.

Dy detyrat themelore pa të cilat ora mësimore nuk mund të jetë e suksesshme janë: përjetimi dhe përvetësimi i masës (taktit) dhe përjetimi dhe përvetësimi i ritmit.

Për ta bërë më të lehtë mësimin e **ritmit**, ne kemi përgatitur **ritmogramet** (shënimi grafik i ritmit ose i një kënge ose kompozimi). Praktikimi dhe ekzekutimi i ritmogramëve nënkupton bashkërendimin e lëvizjeve të nxënësve me ecurinë ritmike të këngës/kompozimit. Në këtë moshë është shumë e rëndësishme, sepse kontribuon në zhvillimin e aftësive të shkëlqyera motorike të fëmijët, përmirëson koordinimin e lëvizjeve, ekuilibrin dhe kontrollin e trupit. Me ndihmën e ushtrimeve të tilla nxënësit/et sinkronizojnë lëvizjet me muzikë dhe ritëm, gjë që kontribuon në aftësinë e tyre për të kryer më mirë dhe në mënyrë më cilësore aktivitetet e ndryshme, mësohen për durim, vetëkontroll dhe përqendrim. Më shpesh, ritmogrami është i shkruar në mënyrë që çdo rrokje e tekstit përshtatet me një simbol. Madhësia e simbolit korrespondon me kohëzgjatjen e notës që ekzekutohet në një rrokje të caktuar të tekstit. Simbolet mund të jenë të ndryshme, dhe më shpesh përputhen me temën e këngës. Në tekstin mësimor për klasën e parë ritmogramet kryesisht janë me ritëm shumë të thjeshtë dhe për simbole janë përdorur ilustrimet e pjesëve të trupit (duart), dukuritë nga natyra (fjollat), kafshët (gaforrja), instrumentet (lahuta, fyelli, zilet, shkopinjë, daulla e vogël) e kështu me radhë. Për shembull:

- paraqitja e ritmit katër të katërtat = katër përplasje të duarve;
- paraqitja e ritmit katërshja - dy tetëshe – katërshja - dy tetëshe = shkopinjë e mëdhenj - dy shkopinj më të vegjël - shkopinjë e mëdhenj - dy shkopinj më të vegjël;
- paraqitja e notave gjysmë - dy katërshe - gjysma - dy katërshe = fjolla e madhe - dy të vogla - fjolla e madhe - dy të vogla;
- paraqitja e notave katërshe – pauza katërshe – nota katërshe – pauza katërshe = simboli - hapësirë boshe - simboli - hapësirë boshe.

Shembulli i përpunimit të këngës së numërimit (lojës muzikore)

1. Mësuesi me nxënës reciton-shqipton këngën e njohur të numërimit, p. sh. *En-den-dini...*
2. Nxënësit/et dëgjojnë mësuesin që shqipton i pari këngën e re e të panjohur të numërimit, duke trokitur me duar në pjesën e parë të taktit, dhe më pas përsërisin këngën e numërimit pjesë nga një pjesë me të.
3. Kur nxënësit të kenë përvetësuar këngën e numërimit, futen lëvizjet e reja. Mësuesi mund t'i shpikë ato, munden po ashtu edhe nxënësit. Gjatë ekzekutimit të këngëve të numërimit, gjëja më e rëndësishme është të mbash të njëjtin ritëm, që të njihet gjithmonë pjesa e theksuar e taktit gjatë shqiptimit ose ekzekutimit në raport me pjesën e patheksuar, por edhe lëvizjet që përsëriten të jenë gjithmonë të njëjta pa ndryshime.

Hapat metodikë për përpunimin e këngës me anë të veshit

Hapat metodikë për përpunimin e një kënge me vesh është një mënyrë për të mësuar një këngë pa shënim të notave, por vetëm duke dëgjuar dhe përsëritur. Qëllimi është që nxënësit/et të zhvillojnë dëgjimin, kujtesën, ekspresivitetin dhe të ndiejnë kënaqësi gjatë këndimit. Procedura metodike përbëhet nga hapat e mëposhtëm:

1. Krijimi i një atmosfere që përputhet me përmbajtjen dhe karakterin e këngës, motivimi i nxënësve për të mësuar këngën e re, duke kënduar ndonjë këngë të mësuar më parë.
2. Dëgjimi me kujdes i këngës, tërën ose vetëm një pjesë, të cilën e interpreton mësuesi/ja. Kënga mund të lëshohet nga ndonjë pajisje audio-vizuale. Vijon analiza e tekstit të këngës.
3. Ridëgjimi i këngës ose i një pjese të saj me përcjellje të zërit ose të lëvizjeve. Nxënësit me mësuesin/en përsërisin disa herë pjesët e këngës, e pastaj krejt këngën.
4. Nxënësit interpretojnë të gjithë këngën në mënyrë të pavarur. Mësuesi u tregon mbi ndonjë gabim të mundshme në ritëm, melodi dhe intonacion. Mund të organizojë forma të ndryshme të ekzekutimit siç janë në grup, individualisht, nën shoqërimin e instrumenteve ose burime të tjera tingullore. Për ta bërë më të lehtë mësimin e këngëve, krahas ritmogramëve për këngët e numërimit, i kemi përgatitur në tekst edhe paraqitjet grafike të melodisë për disa këngë që mësuesi do t'i përpunojë në klasë. Në paraqitjen grafike, çdo rrokjeje të tekstit i përgjigjet nga një simbol. Simbolet janë vendosur në lartësi të ndryshme, sipas lëvizjes së melodisë, ashtu që nëse melodia lëviz lart, simbolet vendosen në drejtimin ngjitës dhe anasjelltas. Madhësia e simboleve i përshtatet kohëzgjatjes së notave që gjinden në këngë, kështu që simboli i madh përdoret për nota të gjata, kurse simboli i vogël për nota të shkurtra. Pamja e simbolit korrespondon gjithmonë me titullin ose tekstin e këngës. Në tekstin mësimor për klasën e parë simboli në paraqitjen grafike të melodisë mund të jetë, për shembull, pema (për këngën e bjeshkës ose malit), djali (për këngën *Hidhu djalë i ri*), gjethja (për këngën e vjeshtës), fjolla e

dëborës (për këngën e dimrit) etj.

Vallet muzikore

Vallja muzikore në mësim nga lënda e Kulturës muzikore mund të ketë lloj-lloj rezultatesh:

- mësimi dhe zhvillimi i njohurive dhe aftësive,
- njohja e instrumenteve muzikore, të qëlluarit p. sh. të instrumenteve ose këngëve, këndimi, luajtja në instrumente,
- imitimi i disa lëvizjeve të sugjeruara paraprakisht,
- perceptimi i tempit dhe ritmit,
- interpretimi i koreografisë së thjeshtë.

Të gjitha vallet muzikore janë të përshkruara në skenarët e orëve mësimore.

Luajtja në instrumentet e instrumentariumit të Orfit

Të luash instrumentet e instrumentariumit të Orfit është një lloj muzikimi që u mundëson fëmijëve të njihen me instrumente të ndryshme muzikore, tinguj dhe ritme. Luajtja në instrumente te parashkollorët dhe në moshën shkollore është shumë me rëndësi, sepse ndikon në zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës. Shumë hulumtime tregojnë se fëmijët që luajnë një instrument në këtë moshë, e kanë të zhvilluar më mirë të folurit, aftësitë motorike dhe vetëbesimin në krahasim me fëmijët që nuk luajnë. Për këtë arsye është edhe një nga qëllimet e lëndës së Kulturës muzikore, pikërisht zhvillimi i kësaj aftësie, prandaj është e rëndësishme të filloni në moshë të re të luani-muzikoni në instrumente.

Koncepti metodik dhe pedagogjik i bazuar në përdorimin e trupit, zërit dhe instrumenteve si mjete për shprehje dhe krijim të muzikës, është i rëndësishëm për fëmijët dhe është e nevojshme të mësohen nxënësit të dallojnë instrumentet ritmike të instrumentariumit të Orfit, t'i mësojnë emrat e tyre dhe t'i përdorin ato. Instrumentariumi i Orfit i lejon fëmijët të luajnë, mësojnë dhe të zhvillojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre muzikore përmes aktiviteteve të ndryshme, sikur se të kënduarit, të rënit-luajtja, të dëgjuarit, të qëlluarit, kompozimi i muzikës ose improvizimi. Instrumentet e Orfit përdoren në mësimin e kulturës muzikore nga klasa e parë deri në klasën e nëntë të shkollës fillore.

Në mësim për klasën e parë përdoren shkopinjë, zilet dhe daulla e vogël, ashtu që me shembuj tekstualë të këngëve gjenden paraqitjet grafike të përcjelljes ritmike.

Dëgjimi i muzikës

Dëgjimi i muzikës është aktiviteti më i rëndësishëm mësimor në lëndën e Kulturës muzikore.

Këtu do të theksojmë se, ne kemi përvojë në punën me fëmijët e kësaj moshe, jemi të udhëzuar/drejtuar në dëgjimin me përjetim të muzikës, por edhe pjesërisht në atë analitik. Dëgjimi i muzikës mund të jetë pjesë e orës mësimore në kuadër të ndonjë teme mësimore ose në kuadër të aktivitetit të paraparë me program, kur nxënësit/et shprehin me fjalë përvojën e tyre ose me lëvizje gjatë ose pas dëgjimit të veprave muzikore, pra përshkruajnë përvojat dhe ndjenjat e tyre në mënyrë narrative ose përdorin vizatimin ose lëvizjen si mjet të shprehjes.

Dëgjimi i muzikës në shkollën fillore është pjesë e kurrikulës (planit dhe programit) për lëndën Kulturë muzikore që realizohet në të gjitha klasat e shkollës fillore. Qëllimi është që nxënësit të zhvillojnë aftësinë për të dëgjuar në mënyrë aktive (dhe kritike) muzikën, si dhe për të marrë njohuri bazë për veprat muzikore dhe mënyrat e tyre të ekzekutimit. Dëgjimi i muzikës është i rëndësishëm për formimin dhe edukimin estetik të nxënësve, sepse u mundëson të përjetojnë bukurinë, emocionet dhe mesazhet që përcjell muzika.

Dëgjimi i muzikës në shkollën fillore përbëhet nga disa faza, të cilat mund t'u përshtaten moshave, interesimit dhe njohurive të mëparshme të nxënësve. Këto faza janë:

- Përgatitja për dëgjim: Në këtë fazë nxënësit motivohen dhe futen në temën për dëgjim, ashtu që u shtrohen pyetje, japin përgjigje ose tregojnë fotografite që lidhen me pjesën muzikore që do të dëgjojnë. Qëllimi i kësaj faze është zgjimi i kureshtjes dhe vëmendjes së tyre, si dhe aktivizimi i njohurive dhe përvojave të tyre të mëparshme.
- Dëgjimi i parë: Në këtë fazë nxënësit njihen me pjesën muzikore të cilën e dëgjojnë, dhe atë e dëgjojnë pa ndërprerje dhe pa koment. Qëllimi i kësaj faze është që nxënësit të fokusohen në përshtypjen e përgjithshme që lë muzika ndaj tyre, gjë që do të shfaqet me një reagim spontan.
- Dëgjimi i dytë: Në këtë fazë nxënësit merren më hollësisht me veprën muzikore që po dëgjojnë, ashtu që e dëgjojnë me detyrat e përmendura që i ndihmojnë t'u kushtojnë vëmendje elementeve ose segmenteve të caktuara të muzikës. Qëllimi i kësaj faze është të zhvillojnë aftësitë e tyre analitike dhe kritike, si dhe të shprehin opinionet e tyre për kompozimin e përzgjedhur.
- Veprimtaria përfundimtare: Në këtë fazë nxënësit mbështeten në përvojat e veta të dëgjimit muzikor, duke përmbledhur përshtypjet e tyre, përfundimet ose mesazhet që kanë marrë gjatë dëgjimit të muzikës. Qëllimi i kësaj faze është që të kuptojnë rëndësinë dhe mirëqenien e dëgjimit muzikor, si dhe të lidhin atë që kanë dëgjuar me atë që kanë mësuar ose përjetuar.

Këta janë hapat metodikë që janë të parashikuar për orën mësimore për dëgjimin e muzikës, por nuk është e detyrueshme të zbatohet në çdo orë ku dëgjohej muzikë, as nuk përmban të gjitha fazat e përmendura për dëgjim. Mësuesi mund t'i shmangë këta hapa duke

respektuar rezultatet, d.m.th duke theksuar ndonjë rezultat tjetër përmes dëgjimit të muzikës.

Gjatë dëgjimit të muzikës, nxënësit/et duhet të bëjnë, secili për vete, emotikonet (emoji). Në fund të librit shkollor ka fletë ngjitëse që përshkruajnë gjendje të ndryshme. Ato duhet të priten dhe të ngjiten në shkopinj. Gjatë dëgjimit të muzikës, çdo nxënës/e duhet ta tregojë se çfarë emocioni ka ngjallë tek ai kompozimi i dëgjuar.



Krijimi dhe kreativiteti

Kur bëhet fjalë për krijimin dhe kreativitetin, në plan të parë është puna individuale e nxënësve. Është përgjegjësi e mësuesit të njohë te nxënësit që në moshë të hershme talentin për muzikë, këndim, luajtje në instrument dhe t'i drejtojnë në shkollë të muzikës, korin e shkollës, korin e qytetit dhe aktivitete të ngjashme. Vëmendje të veçantë nxënësve të talentuar duhet t'i kushtoni në orët e kulturës muzikore, në mënyrë të tillë që të bëjnë detyra më të vështira krahasuar me të tjerët.

Nëpërmjet aktiviteteve në orët e kulturës muzikore, nxënësit zhvillojnë kreativitetin dhe dashurinë e tyre për muzikën. Në këtë mënyrë me ndihmën e mësuesit formohen dëgjues aktivë të muzikës dhe pjesëmarrës në ngjarje kulturore në mjedisin/komunitetin e tyre.

Prandaj, përmes aktiviteteve të ndryshme në orë, nxënësit do të zhvillojnë imagjinatën e tyre dhe kreativitetin, do të krijojnë ritme, ilustrime për dëgjimin e muzikës, do të luajnë në instrumente dhe do të këndojnë. Nga veprat e krijuara mësuesit e kulturës muzikore në fund të vitit mund të krijojnë ekspozitë dhe shfaqje për prindër, nxënës/e të shkollës dhe qytetarë/e të komunitetit. Në këtë mënyrë ata zhvillojnë shpirtin e sipërmarrësit dhe ndjenjën që i përkasin komunitetit-bashkësisë lokale.

Mirë se erdhët fillestarë

(A. Filipoviq)

$\text{♩} = 100$

Ta, ta, ta, ta, ta, gru - pi y - në po na vjen, një grup fi - lle - sta - rësh

4
nxë - nës të s'ardh - mes. Laj - më - roj - në kë - di - min, loj - ën, va - llen, shoq' - ri - min.

7
Mir' se er - dhët fi - lle - sta - rë, nxë - nës në klas' të par'.

Rezultatet e të nxënës

Gjatë mësim, nxënësi/ja do të jetë në gjendje:

- të këndojë këngë popullore dhe artistike (të thjeshta, vargut prej tri tonesh),
- të mendojë përcjelljen e thjeshtë ritmike për këngët e mësuara,
- të vënë re ndryshimin midis lartësive të toneve (duke përdorur lëvizjen e dorës ose riprodhimin me zë).

Incizimi (shënime tingullore): këngë artistike *Mirë se erdhët fillestarë*

Ecuria e orës

1. Hapi/aktiviteti i parë: Nxënësit/et vëzhgojnë me kujdes tekstin mësimor, e shfletojnë dhe e përshkruajnë. Flasin për ilustrimet, komentojnë atë që u pëlqen dhe a kanë vërejtur diçka që e kanë të njohur... Ata flasin për emrin e tekstit mësimor. Mësuesi u lexon atyre parathënien. I udhëzon nxënësit/et të shikojnë ilustrimin e zogut dhe përshkruajnë çfarë është përfaqësuar nga ilustrimet.
2. Hapi/aktiviteti i dytë: Nxënësit/et flasin për ditën e parë në shkollë, paraqesin përshtypjet e tyre, përshkruajnë programin e mirëseardhjes për fillestarët. Mësuesi shpjegon se kjo është edhe tema e këngës *Mirë se erdhët fillestarë*.
3. Hapi/aktiviteti i tretë: Nxënësit dëgjojnë këngën *Mirë se erdhët fillestarë*. Mësuesi/ja e zbaton këtë përmbajtje sipas procedurës metodike të përpunimit të poezisë me vesh. Nxënësit/et ndjekin me kujdes muzikën dhe tekstin.
4. Hapi/aktiviteti i katërt: Kur të mësohet kënga, mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et të vënë re lëvizjen e caktuar muzikore. Pastaj ai i bën ata të shpjegojnë çfarë lëvizjeje kanë vërejtur, duke treguar një nga dy vizatimet: në njërin tregohet vija e drejtë, kurse në të dytin vija e valëzuar. Dëgjojnë me vëmendje këngë. Kur dëgjojnë ndryshimet, reagojnë duke treguar vizatimin përkatës.
5. Hapi/aktiviteti: Në fund të orës së mësim nxënësit hartojnë një përcjellje ritmike të thjeshtë. (përplasja e duarve, kërcitja e gishtave).*

***Për të talentuarit:** Dëgjojnë me vëmendje këngën. Kur të dëgjojnë ndryshimet, ata tregojnë lëvizjet me duar të melodisë lart ose poshtë.

1.

TINGUJT NA RRETHOJNË

Tingujt nga natyra

Rezultatet e të nxënës

Gjatë mësimit, nxënësi/ja do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të emërojë tingujt e ndryshëm në mjedis (klasë, natyrë, shtëpi),
- të dallojë dhe përshkruajë me fjalë dallimin midis termave tingull dhe heshtje/qetësi,
- të njohë ekzistencën e pulsit përmes trokitjeve në natyrë dhe në muzikë,
- të përshkruajë me fjalët e tij karakterin e kompozimeve të ndryshme.

Incizime: Eklipsi, *Pyll shiu*

Xh. Rosini, *Stuhia*


Ecuria e orës

1. Hapi/aktiviteti i parë: Nxënësit/et gjatë hyrjes në klasë, zakonisht bëjnë zhurmë. Mësuesi u thotë të zënë vendet e tyre, të mos flasin, të mos i lëvizin karriget, të mos hapin çantat e shkollës... Është e nevojshme që nxënësit/et të njohin heshtjen/qetësinë. Ata do ta përshkruajnë me fjalët e tyre "tingullin" heshtje...
2. Hapi/aktiviteti i dytë: Nxënësit/et përshkruajnë tingujt që dëgjuan gjatë hyrjes në klasë (gërvimë, përplasje, të folurit me zë të lartë...). Mësuesi me nxënës konstaton se kanë dëgjuar gjithçka me shqisën e dëgjimit.
3. Hapi/aktiviteti i tretë: Nxënësit/et shikojnë ilustrimet në tekstin mësimor (në faqen 7) dhe i komentojnë ato. Mësuesi lëshon shembuj të ndryshëm tingujsh, kurse nxënësit ngjisin fletëngjitëset në rathë bosh (fletëngjitëset gjinden në faqen e fundit të tekstit dhe "përshkruajnë" fishkëllimën e erës, kuakjet e bretkosave dhe gurgullima e përroit). Mësuesi do të përdorë pyetje për t'i drejtuar nxënësit/et në përfundimin se gjithçka që dëgjuan ishin tinguj.
4. Hapi/aktiviteti i katërt: Nxënësit/et dëgjojnë kompozimin *Pyll shiu* nga Eklipsi, dhe pasi dëgjojnë ata përshkruajnë tingujt që dëgjuan (rënia e shiut, cicërimat e zogjeve). Njohin tingujt në natyrë dhe ekzistencën e pulsit përmes trokitjeve/goditjeve në natyrë (mësuesi i nxit që të njohin e dallojnë termin dhe shfaqjen e trokitjeve/rrahjeve në muzikë dhe në mjedisin e tyre, dhe bëjnë lidhjen me ritmin e rënies së shiut, pikimin e ujit, rrahjet e zemrës, tik-takun e orës, ecjen...).

5. Hapi/aktiviteti i 5-të: Nxënësit/et përgatiten për të dëgjuar muzikë: ata marrin një pozë në të cilën do të ndihen rehat gjatë dëgjimit. Dëgjojnë kompozimin *Stuhia*. Pas dëgjimit, përshkruajnë se si u ndjenë gjatë dëgjimit të kësaj vepre (i frikësuar, i shqetësuar...). Herën e dytë dëgjojnë me vëmendje shembullin dhe me ndihmën e mësuesit, i cili i drejton, vërejnë se ndonjëherë muzika është më e qetë, pastaj më e fortë, më e shpejtë, pastaj më e ngadalshme. Mësuesi tregon ilustrimet e një dite të bukur, me diell, përkundër ditës me stuh, me shi dhe nxënësit vijnë në përfundim se cili ilustrim i përgjigjet shembullit të dëgjuar. Mësuesi i informon se vepra e dëgjuar quhet *Stuhia*.

Eci peci pec

(autor i panjohur)



Rezultatet e të nxënës

Gjatë mësimit, nxënësi/ja do të jetë në gjendje:

- të ekzekutojë këngën e numërimit (lojën muzikore) me shqiptim të qartë ritmik të rrokjeve,
- të krijojë shoqërimin ritmik për lojën muzikore (me ndihmën e duarve, këmbëve dhe me kombinime),
- të shoqërojë këngë me instrumentet ritmike të instrumentariumit të Orfit,
- të dallojë instrumentet ritmike të instrumentariumit të Orfit, duke i mësuar emrat e tyre dhe përdorimin (shkopinjë).

Ecuria e orës

1. Hapi/aktiviteti i parë: Nxënësit/et dëgjojnë këngën e numërimit *En, den, dini*. Pas ekzekutimit të këngës në fjalë, mësuesi diskuton për llojin e këngës (këngën e numërimit-lojën muzikore). Nxënësit/et theksojnë dhe shqiptojnë disa që i kanë mësuar tashmë. Së bashku me mësuesin arrijnë në përfundimin se këngët e numërimit përgjithësisht ekzekutohen në mënyrë të ngjashme. Pas kësaj, me ndihmën e mësuesit, krijojnë një shoqërim ritmik për këngën e numërimit-lojën muzikore (me ndihmën e duarve, këmbëve dhe me kombinime).
2. Hapi/aktiviteti i dytë: Nxënësit/et dëgjojnë këngën e numërimit *Eci Peci pec*. Së bashku me mësuesin e shqiptojnë tekstin. Gjatë shqiptimit mësuesi i përcjell nxënësit/et a janë duke i shqiptuar saktë dhe qartë rrokjet.
3. Hapi/aktiviteti i tretë: Nxënësit/et vëzhgojnë instrumentin (teksti mësimor, f. 8). Këta janë shkopinjë (dikujt i duket i njohur ky instrument, sepse e kanë përdorur në kopsht). Me ndihmën e mësuesit përshkruajnë instrumentin. Mësuesi shpjegon se si përdoret. Nëse nuk ka instrument në klasë, do të shërbejnë dy lapsa që mund të zëvendësojnë (disi) shkopinjë.

4. Hapi/aktiviteti i katërt: Nxënësit/et, me ndihmën e mësuesit, ekzekutojnë ritmogramin për këngën e numërimit *Eci Peci pec* (teksti mësimor, f. 8). Mësuesi drejton nxënësit/et të ndjekin simbolet dhe shpjegon se madhësia e tyre korrespondon me kohëzgjatjen.
5. Hapi/aktiviteti i pestë: Nxënësit/et ekzekutojnë këngën e mësuar më parë *Mirë se erdhët fillestare* dhe mendojnë/krijojnë ritmin me shkopinj.*

***Për të talentuarit:** Nxënësit/et mendojnë/krijojnë vetë një ritëm ndryshe nga ai që ofrohet për këngën e numërimit *Eci Peci pec*.

Tingujt nga qyteti

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimi, nxënësi/ja do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të emërtojë tinguj të ndryshëm në mjedisin e tyre,
- të dallojë dhe përshkruajë me fjalë ndryshimin midis termave tingull dhe ton.

Incizime: *Tingujt nga qyteti*

Ecuria e orës

1. Hapi/aktiviteti i parë: Nxënësit/et dëgjojnë shembullin *Pylli shiu*. Bisedojnë për tingujt që dëgjuan në atë shembull. Këta janë tingujt që kanë lindur në natyrë. Mësuesi do të kërkojë nga nxënësit të thonë se cilët janë ata tinguj që njohin nga natyra (tingujt e prodhuar nga kafshët, gjëmimi/murmurima i/e lumit, tingulli i valëve të detit...).
2. Hapi/aktiviteti i dytë: Nxënësit/et dëgjojnë tingullin e bilbilit (të arbitrit/policit) dhe e përshkruajnë atë. Më pas dëgjojnë disa tinguj të përditshëm nga qyteti (ushtima e frenave të makinave, bori treni, zhurmë autobusi...) me detyrë që t'i dallojnë ata. Ata përgjigjen se i dallojnë/njohin tingujt që dëgjojnë në mjedisin e tyre, pastaj ata vetë i prodhojnë dhe i imitojnë ata (imitojnë borinë e kamionit ose frenimin e papritur të makinës...). Më pas komentojnë natyrën, burimin dhe ndalimin e këtyre tingujve dhe dëgjojnë shembuj tingujsh nga qyteti që u lëshon mësuesi. Gjatë dëgjimit, ata shikojnë me kujdes fletëngjitëset e ofruara (që gjenden në fund të tekstit mësimor), i zgjedhin të përshtatshmet dhe i ngjitin në faqen 9.
3. Hapi/aktiviteti i tretë: Nxënësit/et do të kujtojnë vijën e drejtë dhe atë valore/dredha-dredha që tregon lëvizjen muzikore në këngën *Mirë se erdhët fillestare*. Me ndihmën e mësuesit e kuptojnë se përveç tingujve, për të cilët kemi folur (rënia e shiut, tingulli i sirenës, bilbili...), ka edhe tinguj që ndryshojnë lartësinë e vet. Mësuesi demonstroi në një instrument melodik (piano, bllok-flaut etj.) lartësitë e ndryshme të tingujve (toneve). Nxënësit/et vërejnë ndryshimin midis tingujve që nuk kanë lartësi të caktuar dhe atyre që kanë lartësi (ton) të caktuar.
4. Hapi/aktiviteti i katërt: Për të njohur më mirë heshtjen/qetësinë, tingullin (nga natyra dhe nga qyteti) dhe tonin (e interpretuar në instrument ose të kënduar), mësuesi fillon lojën me nxënësit/et. Kur nxënësit/et dëgjojnë tingullin, ata ngrihen nga karriget e tyre, kur dëgjojnë

tonin - ata qëndrojnë ulur, dhe kur dëgjojnë heshtje/qetësinë - vendosin gishtin vertikalisht mbi gojën e tyre. Sigurisht, ata ende nuk mësojnë për tonin, por duhet ta njohin dhe dallojnë tingullin dhe tonin e ekzekutuar në një instrument.

5. Hapi/aktiviteti i pestë: Nxënësit zgjidhin detyrën në faqen 11.

Gjithçka që dëgjon

(A. Perunoviq-Razhnatoviq)



Era fishkëllon,
cikada këndon,
çdo fëmi e di
tingulli është ai.

Ose kur dikush
luan n'saksofon,
duhet që ta dish
se ai quhet ton.

Këngën kur dëgjon
zile n' telefon
edhe ky është ton
çdo f'mi' e kupton

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimet, nxënësi/ja do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të emërtojë tinguj të ndryshëm në mjedis,
- të njohë me dëgjim zërin e fëmijëve dhe të të rriturve;
- të këndojë këngë popullore dhe artistike.

Incizimi: kënga artistike *Gjithçka që dëgjon*

Ecuria e orës

1. Hapi/aktiviteti i parë: Nxënësit/et bisedojnë me mësuesin lidhur me tingujt që mund t'i dëgjojnë nëse jetojnë në qytet (tingujt e makinave, sirenat e ndryshme, shumë zëra, zile/cingërima telefonash...). Pastaj imagjinojnë sikur janë në fshat dhe flasin për tingujt që mund t'i dëgjojnë (tingujt e kafshëve si ai i lopës, rosës, deles, pulës, gjelit ..., tingulli i ziles/trokes që mban lopa a dashi rreth qafës, ...). Mësuesi i tyre njofton se do t'i "çojë" në fshat dhe në qytet me ndihmën e këngës *Gjithçka që dëgjon*, ku do të dëgjojnë tinguj të ndryshëm.
2. Hapi/aktiviteti i dytë: Nxënësit/et dëgjojnë shembullin muzikor - këngën *Gjithçka që dëgjon*. Me ndihmën e mësuesit, ata kuptojnë se në këngë dëgjojnë zërat e fëmijëve dhe zëri i një

të rrituri. Mësuesi lexon tekstin e këngës, kurse nxënësit/et vëzhgojnë ilustrimet e këngëve në tekstin mësimor në faqen 10. Në tekstin e këngës vërejnë termat që kanë mësuar në këtë kapitull (tingullin dhe tonin) dhe përsërisin ato që kanë mësuar.

3. Hapi/aktiviteti i tretë: Mësuesi realizon përmbajtjen sipas hapave metodik gjatë përpunimit të këngës me vesh. Gjatë përgatitjes së këngës mësuesi ua mëson nxënësve frymëmarrjen e duhur dhe shqiptimin e qartë të tekstit.
4. Hapi/aktiviteti i katërt: Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve koreografinë, e cila e ka prejardhjen prej tekstit të këngës:
 - bilbili** (përpiqen të fishkëllejnë)
 - era fishkëllen** (imitojnë erën)
 - luan në saksofon** (i bëjnë lëvizjet sikur luajnë në instrument),
 - zilja e telefonit** (imitojnë rënien e ziles së telefonit).
 - **ushtima** (ushtojnë zëshëm),
 - **këndon qyqja** (imitojnë zogun),

2. THESARET POPULLORE

Nën atë mal të gjelbër (Këngë popullore nga Mali i Zi)

$\text{♩} = 80$
C G C G

Nën a - të, nën a - të mal të gjel - bër o,

5 C G C G

nën a - të, nën a - të mal të gjel - bër o,

I onom i onom	Malo se, malo se	U selu, u selu	U kolu, u kolu,
Lovćen planinom.	selo viđelo.	kolo igralo.	l'jepa đevojka.
I onom i onom	Malo se, malo se	U selu, u selu	U kolu, u kolu,
Lovćen planinom	selo viđelo.	kolo igralo.	l'jepa đevojka.

Rezultatet e të nxënimit

Gjatë mësimit, nxënësi/ja do të jetë në gjendje:

- të këndojë këngë popullore dhe artistike,
- të realizojë koreografi të thjeshta.

Incizimi: këngë popullore *Nën atë mal të gjelbër*

Ecuria e orës

1. Hapi/aktiviteti i parë: Nxënësit në fillim të orës së mësimit së bashku me mësuesin luajnë lojën *telefoni i shurdhër*, e cila synon të shohë se si përmes përcimit/transmetimit me gojë merren informacione të ndryshme si rezultat përfundimtar. Mësuesi ia pëshpërit një fëmije një fjalë të panjohur dhe të vështirë për shqiptim, pastaj ai/ajo tjetrit dhe kështu deri te fëmija i fundit në rresht. Në fund ajo fjalë, kur të gjithë nxënësit/et e shqiptojnë (më shpesh) del ndryshe nga se është dhënë.
2. Hapi/aktiviteti i dytë: Nxënësit/et dëgjojnë me vëmendje këngën *Nën atë mal të gjelbër* me

detyrë që të njohin se për çfarë bëhet fjalë në këngë. Ata e kuptojnë se vjersha/kënga përshkruan krahinat malazeze dhe bjeshkën e Llovenit. Pastaj dëgjojnë këngën e njohur *Gjithçka që dëgjon* si dhe *Nën atë mal të gjelbër* dhe me dëgjim e dallojnë dhe komentojnë ndryshimin. Mësuesi i drejton të shikojnë flamurin pranë vjershës/këngës dhe mësojnë se nuk ka emër të autorit të këngës. I njofton nxënësit/et se disa këngë nuk kanë autor/e, por ato kanë lindur në popull dhe përçohen gojariht – duke i kënduar brez pas brezi. Për këto lloj këngësh themi se janë këngë popullore. Këngët që i kanë shkruar autorët/et, emrat e të cilëve ne i dimë, quhen këngë artistike, siç është kënga *Gjithçka që dëgjon*.

3. Hapi/aktiviteti i tretë: Vijon realizimi i përmbajtjes sipas hapave metodikë të përpunimit të këngës sipas veshit muzikor.
4. Hapi/aktiviteti i katërt: Pasi mësojnë këngën, nxënësit/et ushtrojnë koreografinë e caktuar. Vendosen në një gjysmërreth dhe mësojnë hapat si më poshtë:
 - dy hapa djathtas duke e tërhequr këmbën e majtë,
 - një hap në të majtë duke e tërhequr këmbën e djathtë,
 - godit tri herë me këmbë në dysHEME: me të majtën-me të djathtën-me të majtën.

Durmitor

(Këngë popullore nga Mali i Zi)

$\text{♩} = 80$

Dur - mi - tor, Dur - mi - tor o, Dur - mi - tor, Dur - mi - tor o,

5

o, ti bjeshk' e lar - të, o, ti bjeshk' e lar - të.

Si liqe, si liqeni,
si liqe, si liqeni,
vendi ku kam lindur,
vendi ku kam lindur.

Po të i, po të isha,
po të i, po të isha,
aty pranë liqenit,
aty pranë liqenit.

E të shi, e të shihja,
e të shi, e të shihja,
shtëpinë time t'bardhë.
shtëpinë time t'bardhë.

E në ku, e në kullë,
e në ku, e në kullë,
dashurin' besnike.
dashurin' besnike.

Rezultatet e të nxënës

Gjatë mësim, nxënësi/ja do të jetë në gjendje:

- të interpretojë këngën e numërimit me shqiptim të qartë ritmik të rrokjeve,
- të këndojë këngë popullore dhe artistike,

- të vënë re ndryshimin midis lartësisë së toneve (duke përdorur lëvizjet e duarve ose duke riprodhuar me zë).

Incizimi: kënga popullore *Durmitori*

Ecuria e orës

1. Hapi/aktiviteti i parë: Nxënësit/et këndojnë këngën e dëgjuar *Nën atë mal të gjelbër*. Bisedojnë për këngët popullore, për kohën dhe mënyrën e krijimit të tyre.
2. Hapi/aktiviteti i dytë: Nxënësit/et dëgjojnë me vëmendje këngën *Durmitori*, me detyrë që të njohin temën e këngës. Ata e kuptojnë se kënga përshkruan malin e Durmitorit.
3. Hapi/aktiviteti i tretë: Fillimisht nxënësit/et do të interpretojnë/shqiptojnë si këngë të numërimit këngën *Durmitori*. Mbas dëgjimit të këngës së numërimit, të cilën e thotë/shqipton mësuesi pjesë-pjesë, nxënësit/et mësojnë tekstin, analizojnë lidhjen e rrokjeve si pjesë e tekstit dhe modelit ritmik. Pas vëzhgimit të një vargu ritmik lëvizjesh, ato i aplikojnë duke përdorur trupin për të kryer modele ritmike (duartrokitje ose kërcitja e gishtave). Nxënësit/et ndjekin ritmogramin në tekstin mësimor dhe interpretojnë këngën si këngë të numërimit.
4. Hapi/aktiviteti i katërt: Pas ushtrimit të këngës së numërimit vijon realizimi i përmbajtjes sipas hapave metodikë për përpunimin e këngës me anë të veshit.
5. Hapi/aktiviteti i pestë: Nxënësit/et këndojnë këngën dhe vëzhgojnë pamjen figurative të melodisë në tekstin mësimor. Ata vërejnë ndryshimin midis lartësisë së toneve dhe me lëvizje të duarve tregojnë ndryshime në melodi.

Hidhu djalë i ri

(Këngë popullore nga Mali i Zi)



Rezultatet e të nxënët

Gjatë mësimit, nxënësi/ja do të jetë në gjendje:

- të këndojë këngë popullore dhe artistike,
- të sajojë/krijojë shoqërim të thjeshtë ritmik për këngët e mësuara.

Incizimi: kënga popullore *Hidhu djalë i ri*

Ecuria e orës

1. Hapi/aktiviteti i parë: Nxënësit/et përsërisin këngën e njohur popullore Durmitori dhe diskutojnë për këngët popullore.
2. Hapi/aktiviteti i dytë: Nxënësit/et dëgjojnë me vëmendje këngën Hidhu djalë i ri, dhe pasi dëgjojnë shembullin me ndihmën e mësuesit/es komentojnë se si kënga i bën të luajë në valle. Mësuesi shpjegon se nën këtë këngë interpretohen hapa vallëzimi, më saktë, me të interpretohen valle e kërcime të tjera.
3. Hapi/aktiviteti i tretë: Nxënësit/et mësojnë këngë popullore sipas hapi metodik për përpunimin e këngës sipas veshit. Gjatë këndimit, duhet theksuar veçanërisht pjesa e parë e taktit. Pasi të kenë mësuar, ata e këndojnë këngën individualisht, në grup dhe në çifte.
4. Hapi/aktiviteti i katërt: Nxënësit/et shikojnë ritmogramin e këngës Hidhu djalë i ri dhe instrumentin në tekstin mësimor në faqen 17 (daulla e vogël). Mësuesi tregon instrumentin, shpjegon pamjen e tij dhe mënyrën e prodhimit të tingullit, dhe u ndan nxënësve instrumentet.* Nxënësit/et ndjekin ritmogramin me udhëzimet e mësuesit. Ata ekzekutojnë ritmin pjesë-pjesë. Kur ta përvetësojnë/zotërojnë pjesën ritmike, këndojnë këngën me ritëm.
5. Hapi/aktiviteti i pestë: Nxënësit/et shikojnë një video ku shfaqet ekzekutimi i kërcimit dhe përshkruajnë mënyrën e të luajturit me ndihmën e mësuesit.

***Vërejtje:** Nëse mësuesi nuk e ka numrin e duhur të instrumenteve ose nuk ka asnjë instrument, paraprakisht, gjatë njëres prej orëve, ai do t'u tregojë nxënësve se si ta bëjnë te shtëpia këtë

instrument të ngjashëm me një daulle, që të mund të luajnë së bashku me këtë këngë.

Lahuta

(Këngë popullore nga Mali i Zi)

Gjy-shi la - hu - tës i këndon, diç-ka gjy-shes po i tre-gon, un' dë - gjo - ja me gjysm' zë - ri ,

4
thur - te lav-de për - së - mba-ri". Më pas gjysh-ja m'po-ro - si - ti, dë-gjo fja - lët o lum ni - pi:

7
"kët' la - hut' që kam në do - rë tra - shë - gim e paç gjith - mo - në".

Rezultatet e të nxënitGjatë mësim, nxënësi/ja do të jetë në gjendje:

- të ekzekutojë këngën e numërimit individualisht dhe në grup,
- të njohë vizualisht dhe me zë, si dhe të emërtojë lahutën.

Incizime: regjistrime audio dhe video për lahutën

Ecuria e orës

1. Hapi/aktiviteti i parë: Nxënësit/et këndojnë këngën e famshme Hidhu djalë i ri. Ata diskutojnë për zakonet dhe traditat e popujve në Mal të Zi.
2. Hapi/aktiviteti i dytë: Nxënësit shikojnë ritmogramin në tekstin mësimor dhe analizojnë tekstin e këngës së numërimit Lahuta, dhe më pas e mësojnë pjesë-pjesë. Ata e ekzekutojnë këngën e numërimit me duartrokitje (me katërshe).*
3. Hapi/aktiviteti i tretë: Nxënësit/et shikojnë ilustrimin e instrumentit dhe e quajnë – lahutë. Ata flasin për lahutën, disa prej tyre e kanë instrumentin në shtëpi, e disa prej familjarëve dinë t'i bien lahutës.
4. Hapi/aktiviteti i katërt: Nxënësit/et dëgjojnë shembullin për lahutë dhe komentojnë ngjyrën e tingullit (tonit). Duke parë ilustrimin në tekstin mësimor, ata e përshkruajnë atë dhe tregojnë se si të mbahet lahuta gjatë ekzekutimit. Vëzhgojnë një model të instrumentit që ua tregon mësuesi. Ngjyrat e instrumentit në tekstin mësimor.

***Sugjerim:** Kur të kenë mësuar këngën, i ndajnë rolet: nipi, gjyshja, gjyshi.

Cyle dyjare (bicula)

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimit, nxënësi/ja do të jetë në gjendje:

– të njohë vizualisht dhe me zë dhe të emërtojë cylen dyjare.

Incizime: regjistrimet audio dhe video për cylen dyjare

Ecuria e orës

1. Hapi/aktiviteti i parë: Nxënësit/et ekzekutojnë këngën e numërimit *Lahuta*, të cilën e kanë mësuar orën e kaluar. Përshkruajnë strukturën e instrumentit (lahuta) dhe mënyrën e përfitimit të tonit.
2. Hapi/aktiviteti i dytë: Nxënësit/et dëgjojnë shembullin audio, me detyrë që të njohin se kush është duke interpretuar kompozimin - një instrument apo një zë njeriu (interpreton instrumenti).
3. Hapi/aktiviteti i tretë: Nxënësit/et vëzhgojnë modelin e instrumentit të cilin e tregon mësuesi. Vëzhgojnë edhe pamjen e instrumentit që gjindet në tekstin mësimor dhe e krahasojnë me modelin e paraqitur. Përshkruajnë pamjen e instrumentit. Vërejnë se është shumë i thjeshtë, i ndërtuar prej drurit, përbëhet nga dy gypa/tuba, prej nga vjen emri i fyellit me dy tuba *cyle dyjare*, *bicule* ose *binjak*. Në gypa gjinden vrimat. Mësuesi shpjegon se është instrument popullor që kur i bihet mbahet përpara vetes, kurse tingulli përftohet duke fryrë ajrin në gyp. Ai gjithashtu shton se zakonisht cylet dyjare janë zbukuruar duke u gdhendur dhe se instrumenti është dukshëm baritor.
4. Hapi/aktiviteti i katërt: Nxënësit/et shikojnë incizimin video, shembullin e cyles dyjare dhe me ndihmën e mësuesit përshkruajnë ngjyrën e tonit.
5. Hapi/aktiviteti i pestë: Nxënësit/et ngjyrosin ilustrimin e instrumentit në tekstin mësimor.

Nina, zemra ime

(Këngë popullore nga Kroacia)



Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimit, nxënësi/ja do të jetë në gjendje:

- të këndojë këngë popullore dhe artistike,
- të sajojë/krijojë shoqërimin e thjeshtë ritmik për këngët e mësuara.


Incizimi video: valle popullore nga Sllavonia (Kroaci)

Ecuria e orës

1. Hapi/aktiviteti i parë: Nxënësit/et nën shoqërimin e mësuesit këndojnë këngën e njohur *Nën atë mal të gjelbër*.
2. Hapi/aktiviteti i dytë: Nxënësit/et diskutojnë për rutinën e tyre të përditshme, si kalojnë ditën e tyre, sa kohë kalojnë duke luajtur, duke bërë detyrat e shtëpisë, si ndihen në fund të ditës... Ata përgjigjen se janë shumë të lodhur dhe mezi presin për të fjetur. Mësuesi i pyet nëse prindërit u lexojnë tregime para se të flenë ose këndojnë këngë. Si quhen këngët që këndohen para se të flini?
3. Hapi/aktiviteti i tretë: Nxënësit/et dëgjojnë tekstin e këngës *Nina, zemra ime*, të cilin e lexon mësuesi/ja. Duke cituar mësuesin, ata arrijnë në përfundimin se kënga është ninullë. Më pas vijon realizimi i hapave metodikë të përpunimit të këngës sipas veshit.
4. Hapi/aktiviteti i katërt: Shikojnë ilustrimet në tekstin mësimor në faqen 21 dhe vërejnë flamurin e një shteti tjetër. Mësuesi i informon se është flamuri i Kroacisë, sepse kënga që mësuam është këngë popullore nga Kroacia.
5. Hapi/aktiviteti i pestë: Nxënësit/et shikojnë një video të valles popullore të Sllavonisë, të cilën mësuesi ua lëshon. Me kujdes e shikojnë incizimin dhe më pas me ndihmën e mësuesit komentojnë këndimin, vallëzimin, veshjet që veshin interpretuesit.
Vërejnë se dallohen nga ato malazeze. Mësuesi u shpjegon atyre se në shtetin tonë përveç malazezëve jetojnë edhe popuj të tjerë dhe se të gjithë kanë vallet e tyre popullore.
6. Hapi/aktiviteti i gjashtë: Nxënësit/et me ndihmën e mësuesit/es hartojnë/krijojnë shoqërimin ritmik për këngën: një grup nxënësish/esh marrin shkopinjë, kurse grupi i dytë do të kërcas gishtat. Nxënësit/et ushtrojnë ritmin, e ekzekutojnë atë në grupe dhe më pas grupet ekzekutojnë ritmin së bashku.

Vjeli, vjeli rrushin

(Këngë popullore nga Serbia)



Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimet, nxënësi/ja do të jetë në gjendje:

- të këndojë këngë popullore dhe artistike,
- të këndojë këngë popullore dhe artistike në vëllim të përshtatshëm, përmbajtja e të cilave inkurajon imagjinatën, vallëzimin dhe lojën.
- të vënë re ndryshimin midis lartësive të toneve (duke përdorur lëvizjet e duarve ose duke riprodhuar me zë).

Incizimi: këngë popullore *Vjeli, vjeli rrushin*

Ecuria e orës

1. Hapi/aktiviteti i parë: Nxënësit/et diskutojnë me mësuesin për stinët e vitit dhe dukuritë karakteristike që lidhen me to (në verë dielli shumë nxeh, në dimër bie borë, në vjeshtë bie shi, në pranverë gjithçka gjethon). Diskutojnë edhe për ndryshimet në natyrë dhe dhuratat nga natyra që na sjell ndonjë stinë. Ndalemi në vjeshtë dhe nxënësit/et komentojnë se në atë kohë piquen mollët, dardhat, kumbullat... Me ndihmën e mësuesit vijnë në përfundimin se edhe rrushi piqet në atë kohë. Hapi/aktiviteti i dytë: Nxënësit/et shikojnë ritmogramin e këngës *Vjeli, vjeli rrushin* në tekstin mësimor dhe verifikojnë nëse është popullore (vërejnë se nuk ka emër autori dhe flamur pranë titullit të këngës). Kur e njohën se është këngë popullore, mësuesi e ekzekuton atë (ose e lëshon shembullin tingullor), dhe më pas me nxënësit dhe nxënësit komentojnë tekstin. Viojnë hapat metodik për përpunimin e këngës sipas veshit.
2. Hapi/aktiviteti i tretë: Pasi kanë mësuar këngën, shikojnë me kujdes tekstin e tyre mësimor "lëvizjet e rrushit". Gjatë dëgjimit të këngës, të interpretuar nga mësuesi, nxënësit/et vënë re ndryshimin midis lartësive të toneve dhe me dorë tregojnë lëvizjen e melodisë.
3. Hapi/aktiviteti i katërt: Pasi të kenë mësuar këngët, nxënësit luajnë lojën/vallen, të cilën ua ka shpjeguar më parë mësuesi.
4. Përshkrimi i lojës/vallëzimit: Nxënësit formojnë rrethin. Një nxënës qëndron në mes të lojës/valles. Ai është rojtari i rrushit – "xhaxhi". Nxënësit/et qëndrojnë në rreth (valle) dhe

këndojnë. Imitojnë vjeljen e rrushit me lëvizjet e duarve, pastaj e këpusin kokrrën e rrushit dhe e vendosin në gojë dhe vilën në shportë. Ndërsa mbledhin rrushin, ata shikojnë me kujdes rojën. Te fjala e fundit nxënësit/et shpërndahen/ikin, se po vjen roja. Atë që e kap roja, bëhet “xhaxha”.

5. Hapi/aktiviteti i pestë: Nxënësit/et zgjidhin labirintin në tekstin mësimor.

3. RITMI I STINËVE TË VITIT

Vjeshta (M. Matanoviq)

$\text{♩} = 60$

Cm G G G Cm Fm Cm

Gje - thi bjen nga de - ga, e shtri - het mbi to - kë, nën çdo gje - the posh - të

4 G Cm Cm G G G Cm

mi - lin - go - na për - plot. Kur - se zogj - të shteg - ta - rë, n'at' mo - ment të zym - të,

7 Fm Cm G Cm Cm Fm

jan' ga - ti të ni - sen n'udh' - ti - me të larg' - ta. Vjesh - të bu - zë rru - gës po

10 Fm Cm Fm G Cm G Cm

fryn' er' e for - të, një ndër pall - tot e ver - dha, e ka marr' nga ve - ra.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë orës, nxënësi/ja do të jetë në gjendje:

- të këndojë këngë popullore dhe artistike në një vëllim të përshtatshëm, përmbajtja e të cilit inkurajon imagjinatën, lojën dhe vallëzimin,
- të vërejë ndryshimin midis lartësive të toneve (duke përdorur lëvizjet e duarve ose duke riprodhuar me zë).

Incizimi: kënga artistike *Vjeshta*

Ecuria e orës

1. Hapi/aktiviteti i parë: Nxënësit/et u përgjigjen pyetjeve:
 - 1) Herë në tokë e herë në bar, e herë bashkon zahire. Kur vjen dimri i ftohtë, ai ka lajthia e gështenja. Nuk është njëri, nuk është zog. Emri i tij është ... (ketri).
 - 2) Era e lëkund në degën e vet duke e zverdhur pas verës së nxehtë. Çdo libër e ka atë. Kush është ai? – pyetja është për nxënësin fillestar ... (gjethi).
 - 3) Kur e sheh, ariu ndalon. “Si të vij tani deri te ushqimi”? Në dru rritet, shushurin, e pjekur është ajo, e ngjyrë verdhë, ... (dardha).

Kur t'i qëllojnë të tre termat (ketri, gjethi, dardha), mësuesi i pyet ata në cilën kohë të vitit hanë dardha? Cilat kafshë pëlqejnë dardhat? Kur gjethet zverdhen dhe bien? Cilat kafshë të tjera mbledhin ushqim? Vijnë në përfundimin se është fjala për vjeshtën.
2. Hapi/aktiviteti i dytë: Nxënësit/et dëgjojnë këngën e lexuar nga mësuesi dhe flasin për tekstin. Me shpjegim të tekstit (pse milingonat grumbullohen, çfarë është shtroja e artë, pse zogjtë shtegtarë udhëtojnë në distanca/rrugë të gjata), me ndihmën e mësuesit vijnë në përfundimin se përshkruhen ndryshimet në natyrë që shënohen në vjeshtë.
3. Hapi/aktiviteti i katërt: Nxënësit/et shikojnë paraqitjen grafike të melodisë së këngës në tekstin mësimor në faqen 25. Diskutojnë për pozicionin e simboleve të shënuara/paraqitura. Ata vërejnë se simbolet nuk janë në të njëjtin nivel, por në lartësi të ndryshme. Nxënësit/et marrin për detyrë, që mbas dëgjimit të këngës të vijnë në përfundim pse është paraqitur kështu kënga? Nga ata pritet që lëvizjet e toneve në melodi do t'i lidhin me lartësitë në të cilat ndodhen simbolet. Nëse nuk arrijnë, mësuesi i ndihmon ata. Vijnë realizimi i përmbajtjes sipas hapave metodik për përpunimin e këngës sipas veshit.
4. Hapi/aktiviteti i pestë: Pasi të mësohet kënga, nxënësit/et e këndojnë të tërën në grup, në çifte ose individualisht, nën shoqërimin e mësuesit.
5. Hapi/aktiviteti i gjashtë: Më në fund nxënësit/et do të imitojnë tingujt e vjeshtës nga natyra me ndihmën e trupit dhe zërit të tyre (me zërin e tyre imitojnë erën, duke fërkuar pëllëmbët e duarve imitojnë shiun e imët, kurse me kërcitje të gishtave pikat e mëdha të shiut, me përplasje të herëpashershme të duarve mbi gjunjë shiun e rëndë dhe duke shkëlmuar dyshtemenë imitojnë goditjen e rrufesë).

Shiu

(A. Filipoviq)

Shi - u bi - e an - e - mban', jash - të gjy - shen e ka zën'.

5 Me vrap ni - pi kur e pa, gjy - shes ça - drën i - a dha,

9 o bi - ri im, gjy - shja tho - të, po pse u bë - re ti qull kot.

13 Mos u bren - gos gjy - she ti, ta - ni tha - hem në shtë - pi.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimit, nxënësi/ja do të jetë në gjendje:

- të ekzekutojë këngë të shkurtra numërimi,
- të ekzekutojë këngën e numërimit me shqiptim të qartë ritmik të rrokjeve,
- të krijojë shoqërimin ritmik për këngë të numërimit (përmes duarve, këmbëve dhe me kombinim të të dyjave),
- të njohë përmes dëgjimit shembujt e propozuar tingullorë,
- të interpretojë koreografi të thjeshta.

Ecuria e orës

1. Hapi/aktiviteti i parë: Nxënësit/et dëgjojnë shembullin që mësuesi u lëshon (Xh. Rosini, *Stuhia*), me detyrë që të njohin shembullin. Pasi që e njohin, diskutojnë për ndjenjat/përshtypjet që la tek ta kompozimi i dëgjuar.
2. Hapi/aktiviteti i dytë: Nxënësit/et dëgjojnë me vëmendje nga mësuesi shqiptimin e këngës së numërimit *Shiu*. Ata gradualisht e përvetësojnë këngën e numërimit, duke e mësuar atë pjesë-pjesë, me ndihmën e mësuesit.
3. Hapi/aktiviteti i tretë: Pasi nxënësit/et të kenë përvetësuar këngën e numërimit, ata krijojnë shoqërimin ritmik për këngën e numërimit me ndihmën e duarve, këmbëve dhe me kombinime.
4. Hapi/aktiviteti i katërt: Nxënësit/et mësojnë lojën/lëvizjet që shoqërojnë tekstin e këngës së numërimit, të cilën ua tregon mësuesi:

Përshkrimi i lojës:

Shiu bie anembanë - imitojnë shiun që bie

Jashtë gjyshen e ka zënë – shtrembërohen pak - kërrusen

Vrapoi nipi kur e pa - fëmijët vrapojnë në vend

Gjyshes çadrën ia dha - mbartin një çadër/ombrellë

O biri im, gjyshja thotë - i përkëdhel kokën shokut

po pse u bëre ti qull kot – fshijnë këmbët

“Mos u brengos gjyshe ti - merr “gjyshen” për dore (zgjedh ndonjë nxënës/e nga grupi)
ani thahem në shtëpi “– hidhet lart/kërcen dhe shkund shiun nga vetja.

Kënga e dimrit

(M. Matanoviq)

C G C C G C

3 C Fjo - lla, fjo - lla bi - e bor', rru - gët jan' shtru - ar me or'.

në dri - ta - re ko - kat var', ja da - lin për të par'.

5 C G C C G C

me ka - pe - le të gjith' jashtë, mbësh - tje - llë me shall të trash',

7 C C G C

po fi - llojn' lo - jë - rat, nuk nda - len to - pë - that.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimit, nxënësi/ja do të jetë në gjendje:

- të këndojë këngë popullore dhe artistike.

Incizimi: kënga artistike *Kënga e dimrit*

Ecuria e orës

1. Hapi/aktiviteti i parë: Nxënësit/et shikojnë ilustrimet nga teksti mësimor (faqe 27). Dëgjojnë tregimin e vajzës së vogël Klarës dhe takimin e saj me dimrin, të cilën ua lexon mësuesi.*
2. Hapi/aktiviteti i dytë: Pas leximit të tregimit, nxënësit/et komentojnë, tregojnë se për cilën stinë të vitit bëhet fjalë, përshkruajnë ngjarjet e dimrit dhe shprehin ndjenjat e tyre. Mësuesi paralajmëron mësimin e këngës.
3. Hapi/aktiviteti i tretë: Nxënësit/et dëgjojnë tekstin e këngës, të cilin e lexon mësuesi. Ata vërejnë se kënga ka të bëjë me dimrin. Mësuesi këndon pjesë-pjesë këngën, kurse nxënësit/et përsërisin pas tij, sipas hapave metodikë të përpunimit të këngës sipas veshit.
4. Hapi/aktiviteti i katërt: Nxënësit/et këndojnë këngën në mënyrë të pavarur, nën shoqërimin instrumental të mësuesit.

Ditë dimri

(M. Matanoviq)

Klara ka luajtur me violinë në këndin e preferuar të dhomës së saj, pranë dritares. Babi dhe mami

ishin në punë, detyrat e shtëpisë i kishte mbaruar qysh herët dhe kohën e lirë të saj e kaloi nën shoqërimin e tingujve magjikë të violinës, duke luajtur me mikeshat e saj dallëndyshet. Fëmijët e tjerë kishin qen ose kotele, kurse Klara kishte dallëndyshe. Derisa rrezet e diellit me turp e fshehurazi dilnin, vështrimi i saj u end nëpër dritare dhe u ndal në folenë e boshatisur të dallëndyshe në tarracë. Ajo papritmas psherëtiu e trishtuar. Dallëndyshet gjatë gjithë verës cicëronin me gëzim në tarracën e banesës së saj dhe shfaqjet e tyre të përbashkëta ishin aventura të vërteta muzikore.

Ndërsa ajo po mendonte e trishtuar për dallëndyshet, përmes dritares pa fjollat e bardha të borës që ranë nga qielli. Ajo ndjeu një kthjelltësi rreth zemrës së saj dhe mendoi se si dallëndyshet u larguan për të lënë vend për mysafiret e reja. Bora ka ardhur! Klara shpejt u vesh, vuri kapelën në kokë dhe doli jashtë. I shikonte me magjepsje flokët e borës teksa kryenin vallëzim të pazakontë dhe binin përtokë. Eci për një kohë të gjatë dhe kapi fjollat e borës që nuk zinin vend. Në një moment, ajo pa fëmijë duke luajtur në dëborë. Klara u afrua dhe takoi një botë të re. Me miqtë e saj i ka shijuar magjitë e dimrit dhe lojërat: bënë Borëbardhën, patinazh, slitë dhe u gëzuan me fjollat e para të borës.

Kur u kthye në shtëpi, e priste një surprizë tjetër. Prindërit dhe vëllai i saj shpaketuan bredhin e Vitit të Ri dhe pritën Klarën që ta stolisnin së bashku. Babai e vendosi bredhin e Vitit të Ri dhe dritat, fëmijët fjongot dekorative dhe zbukurimet e tjera në degët e ulëta, kurse mami vendosi zbukurimet në degët e larta.

Viti i Ri

(A. Filipoviq)

Vi - ti i ri po vjen në kë - të nat', për të na sje-llë lum-tu - ri e-dhe fat.

Mes - na - ta af - ron, o - ra tro - ket, shpejt vij - në dhu - ra - tat në o - rën dymb'-dhjet'.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimit, nxënësi/ja do të jetë në gjendje:

- të këndojë këngë popullore dhe artistike,
- të krijojë shoqërimin e thjeshtë ritmik për këngët.

Incizime: Kënga artistike *Viti i Ri*,

këngë artistike *Zilja tring* (për ta dëgjuar)

Ecuria e orës

1. Hapi/aktiviteti i parë: Nxënësit/et përsërisin këngën e njohur *Vjeshta* dhe diskutojnë për tekstin. Diskutojnë për ndryshimet në natyrë dhe si ndryshojnë stinët e vitit. Këto ndryshime na sjellin edhe gëzimin e festave. Mësuesi tregon kapelën e babadimrit, zbulimet e bredhit të Vitit të Ri e ngjashëm, kurse nxënësit e kuptojnë se çdo gjë që panë lidhet me festën e Vitit të Ri.
2. Hapi/aktiviteti i dytë: Nxënësit dëgjojnë këngën *Viti i Ri* që ua lëshon mësuesi (ose interpreton në piano), më pas diskutojnë tekstin e këngës. Viojnë hapat metodikë për përpunimin e këngës sipas veshit.
3. Hapi/aktiviteti i tretë: Pasi mësohet kënga, nxënësit/et këndojnë individualisht, në grup dhe sipas rreshtave.
4. Hapi/aktiviteti i katërt: Nxënësit/et shikojnë ritmogramin në tekstin mësimor (faqe 29). Vërejnë një instrument të ri, i cili është i njohur për shumicën. Konstatojnë se janë rraketaket (maracas) dhe i përshkruajnë ato.
5. Hapi/aktiviteti i pestë: Nxënësit/et ekzekutojnë ritmogramin me ndihmën e mësuesit, i cili i njofton me modelet elementare ritmike, në mënyrë që të mund të zotërojnë ritmin si një nga elementët bazë të muzikës.
6. Hapi/aktiviteti i gjashtë: Nxënësit/et dëgjojnë këngën *Zilja tring* (e cila është më se e njohur dhe e preferuar për ta, sepse dëgjohej shpesh gjatë festave të fundvitit). Pas dëgjimit të parë e njohin këngën si pjesë të atmosferës së Vitit të Ri dhe si paralajmërimi i festave të ardhshme. U jepet për detyrë që gjatë dëgjimit për herë të dytë të krijojnë ritmin për shoqërimin e këngës, me instrumentet që përdorën për këngën e mësuar më parë, *Viti i Ri*.*

***Vërejtje:** Përveç rraketakeve, të cilat janë përdorur për përpunimin e këngës *Viti i Ri*, në orë

mund të përdoren gjithashtu edhe instrumente të tjera që simbolizojnë atmosferën e Vitit të Ri - trekëndëshi, këmbanat-zilet.

Pranvera

(M. Matanoviq)

$\text{♩} = 100$

D A D D D A D

Lu - le bo - rë bar - dha, ta - ni lum - tu - ro - het,

3 D A D A D A A

e kjo lu - le - vjoll - ca jo - në shum' po lar - të - so - het.

5 D A D D D A D D

Në qie - llin e kal - tër, Die - lli rro - tu - llo - het,

7 D A D D D A D

çdo qe - nie e gja - llë, pran - ve - rës i gë - zo - het.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimin, nxënësi/ja do të jetë në gjendje:

- të këndojë këngë popullore dhe artistike,
- të vërejë ndryshimin midis lartësive të toneve (duke përdorur lëvizjet e duarve ose duke riprodhuar me zë).

Incizime: kënga artistike *Pranvera*,
muzike nga filmi vizatimor *To spring*

Ecuria e orës

1. Hapi/aktiviteti i parë: Nxënësit/et shikojnë filmin e shkurtër vizatimor *To spring*.
2. Hapi/aktiviteti i dytë: Nxënësit/et diskutojnë për filmin vizatimor. Ata vënë re se në natyrë po ndodhin ndryshime që paralajmërojnë pranverën. Me inkurajimin e mësuesit lidhin muzikën dhe veprimin dhe më pas i thonë karakteristikat e muzikës që dëgjuan - njohin dhe emërtojnë tinguj që imitojnë ujin që pikon, fishkëllimën e erës dhe stuhinë.
3. Hapi/veprimtaria e tretë: Mësuesi lexon tekstin e këngës *Pranvera*. Nxënësit/et diskutojnë

tekstin dhe përshkruajnë lajmëtarët e pranverës. Vëzhgojnë ritmogramin dhe më pas ekzekutojnë lëvizje ritmike sipas simboleve të dhëna (përplasnin duart, kërcasin gishtat, godasin me këmbë në dysheme).

4. Hapi/aktiviteti i katërt: Pasi kanë përvetësuar ritmin e këngës, vijojnë hapat metodikë për përpunimin e këngës sipas veshit.
5. Hapi/aktiviteti i pestë: Nxënësit/et këndojnë këngën *Pranvera* dhe me lëvizje të duarve tregojnë dallimin midis lartësive të tingujve.

Maçoku

(A. Filipoviq)

Val - mi - ri po qan se ka hum - bur ma - ço - kun,

5 e - ja e - ja ma - ço, mos më le të ve - tëm.

9 Mja - u, mja - u mja - u, mja - u - lli - mën e dë - gjoj,

13 ni - si të kër - ce - jë, lo - tët i ha - rro - i.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimit, nxënësi/ja do të jetë në gjendje:

- të ekzekutojë këngën e numërimit me shqiptim të qartë ritmik të rrokjeve,
- të krijojë shoqërimin ritmik për këngën e numërimit (me ndihmën e duarve, këmbëve dhe me kombinime).

Incizimi: Xh. Rosini, *Dueti i maceve*

Ecuria e orës

1. Hapi/aktiviteti i parë: Nxënësit/et, së bashku me mësuesin, përsërisin këngën e njohur të numërimit. Me kujdes riprodhojnë ritmin e këngës së numërimit me shqiptim të qartë të rrokjeve. Mësuesi gjatë punës me këngë të numërimit gjithmonë e kthen vëmendjen e nxënësve në ritmin dhe shqiptimin e tekstit.
2. Hapi/aktiviteti i dytë: Nxënësit/et analizojnë tekstin e këngës së re të numërimit dhe komentojnë përmbajtjen e saj humoristike. Mësuesi i njofton ata me ritmin e këngës së numërimit dhe i shqipton me saktësi rrokjet. Vijnë hapat metodikë për përpunimin e këngës së numërimit.
3. Hapi/aktiviteti i tretë: Nxënësit/et, sipas dëshirës, në mënyrë të pavarur shqiptojnë ritmin e këngës së numërimit dhe përdorin trupin si burim tingulli, duke ekzekutuar ritmin e duhur me pëllëmbë, trokitje në bankë dhe me këmbë në dysHEME.
4. Hapi/aktiviteti i katërt: Nxënësve u jepet për detyrë që të dëgjojnë shembullin muzikor Dueti i maceve dhe të njohin se kush është duke interpretuar kompozimin dhe çfarë përfytyrohet me muzikë. Ata vënë re se bëhet fjalë për zëra të femrave dhe se duke kënduar po imitojnë macet. Mësuesi shpjegon se Dueti i maceve është i famshëm dhe shpesh shembulli i interpretuar është i shënuar për dy zëra femrash dhe piano. I gjithë teksti është shumë i thjeshtë, përbëhet nga vetëm një fjalë - mjau, dhe veprimi paraqet "bisedën" midis dy maceve.

Vera

(M. Matanović)

♩ = 80

C C G G C G C C
 Fë - mi - jët po bro - ho - ra - sin, na erdh ver' e nxeh - të,
 5 C C G G C G C C
 plot me ënd' - rra për - je - ti - me, që do t'jen' kuj - ti - me.
 9 C C G G C G C C
 Fë - mi - jët po lum - tu - ro - hen, këng' e g'zu - ar po dë - gjo - het.
 13 C C G G C G C C
 Ni - sen he - rët pa - ra dri - te, për t'u lar' në det.
 17 C C G G C G C C
 Di - të e nxeh - të kër - kon fres - kun, la - hen e - dhe no - toj - në.
 21 C C G G C G C C
 Më në fund kur bi - e na - ta, lu - aj ku - ka - fsheh - tas.

Rezultatet e të nxënimit

Gjatë mësimit, nxënësi/ja do të jetë në gjendje:

- të këndojë këngë popullore dhe artistike,
- të ekzekutojë aranzhimin e thjeshtë me shkopinj

Incizimi: këngë artistike Vera

Ecuria e orës:

1. Hapi/aktiviteti i parë: Nxënësit shikojnë ilustrimet që ua tregojnë mësuesi (ilustrime të dukurive karakteristike për çdo stinë). Pasi i kanë njohur stinët e vitit, u tregojnë atyre

“rekuizitat” (maskën për zhytje, guralecë, komardare plazhi, krem kundër diellit...) nga ku konkludojnë se është fjala për verën.

2. Hapi/aktiviteti i dytë: Nxënësit/et dëgjojnë shembullin tingullor – këngën *Vera*. Mësuesi këndon këngën pjesë-pjesë, duke realizuar përmbajtjen sipas hapave metodikë të përpunimit të këngës sipas veshit, kurse nxënësit/et mësojnë përmendësh tekstin. Kur të mësohet kënga, nxënësit/et këndojnë në çift ose individualisht.
3. Hapi/aktiviteti i tretë: Nxënësit/et vëzhgojnë paraqitjen grafike të melodisë së këngës në tekstin mësimor (faqe 32). Vënë re se simbolet që janë pikturuar nuk janë të gjitha të vendosura në të njëjtin rresht, por në lartësi të ndryshme. Nxënësit/et marrin për detyrë që mbas dëgjimit të këngës të vijnë në përfundim se pse është paraqitur kështu kënga. Nga ata pritet që të lidhin lëvizjen e melodisë me lartësitë në të cilat ndodhen simbolet. Nëse nuk arrijnë vetë, për këtë u ndihmon mësuesi.
4. Hapi/aktiviteti i katërt: Nxënësit/et ekzekutojnë këngën individualisht ose në grup me përcjellje të shkopinjeve.

Ditë me diell

(A. Filipoviq)

Kur është dit' e bu - kur shumë, flu - tu - roj si - një pë - llumb, kur një re e mbu - lon die - llin,

nuk më bë - het ta shoh qie - llin. Sho - kët më thë - rra - sin jashtë, që të lo - zim të gjith' bashk',

për - shën - de - tje gjith' sa je - ni, shih - ni çfa - rë di - te ke - mi.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimi, nxënësi/ja do të jetë në gjendje:

- të ekzekutojë këngë të numërimit me shqiptim të qartë ritmik të rrokjeve,
- të krijojë përcjelljen ritmike për këngë të numërimit (me ndihmën e duarve, këmbëve dhe me kombinimin e të dyjave).

Ecuria e orës

1. Hapi/aktiviteti i parë: Nxënësit/et përsërisin këngën e njohur të numërimit dhe ekzekutojnë ritmin me ndihmën e duarve, këmbëve dhe me kombinimin e të dyjave.
2. Hapi/aktiviteti i dytë: Nxënësit/et diskutojnë me mësuesin se çfarë përfaqëson lumturia

për ta. Mësuesi i inkurajon të bëjnë sa më shumë përgjigje të ndryshme dhe disa nga nxënësit/et do të përmendin lojën dhe motin e bukur.

3. Hapi/aktiviteti i tretë: Gjatë diskutimit, mësuesi paralajmëron një këngë numërimi, e cila përshkruan pikërisht ndjenjën e lumturisë që ndodh kur fëmijët luajnë. Mësuesi shqipton këngën e numërimit dhe thekson me kujdes elementet ritmike në të. Nxënësit/et e ndjekin ekzekutimin dhe më pas e përsërisin disa herë me mësuesin, pjesë-pjesë, derisa ta përvetësojnë plotësisht.
4. Hapi/aktiviteti i katërt: Mësuesi i udhëzon nxënësit/et të përdorin trupin e tyre si burim tingulli duke përplasur pëllëmbët njëra për tjetrës, duke kërcitur gishtat, duke goditur me këmbë në dysHEME dhe në këtë mënyrë krijojnë ritmin për këngë të numërimit.

Gaforrja

(A. Filipoviq)

Te - rri bie u bë von', ga - forr - ja streh' kër - kon.

5 Ni - set ra - xha dal' nga - da - lë, ga - fo - rres i del për - ba - llë.

9 Ti ga - fo - rre ni - su shko, shtë - pin' tën - de ti kër - ko,

13 a - ty prit di - tën e re, e si - gurt ti je.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimit, nxënësi/ja do të jetë në gjendje:

- të ekzekutojë këngë të shkurtra numërimi,
- të ekzekutojë këngën e numërimit me shqiptimin e saktë ritmik të rrokjeve,
- të interpretojë koreografi të thjeshtë.

Incizimi: muzikë nga filmi vizatimor *Sirena e vogël*.

Ecuria e orës

1. Hapi/aktiviteti i parë: Nxënësit/et këndojnë këngën e mësuar *Vera*. Kujtojnë tekstin e këngës dhe diskutojnë për të shkuar në det. Me drejtimin e mësuesit, nxënësit/et listojnë kafshët që jetojnë në det. Ndër kafshët e listuara do të përmendin edhe gaforren. Imitojnë se si lëviz gaforrja, si duket dhe çfarë ngjyre ka?
2. Hapi/aktiviteti i dytë: Nxënësit/et ndjekin me kujdes ekzekutimin e këngës së numërimit. Më pas, me ndihmën e mësuesit, ata përvetësojnë këngën e numërimit sipas pjesëve, duke e përsëritur disa herë.
3. Hapi/aktiviteti i tretë: Përpara se të fillojë loja/vallëzimi, nxënësit/et mes vete zgjedhin "rraxhën", dhe të tjerët do të jenë "gaforre".* Ndjekin mësuesin që u tregon koreografinë/lëvizjet e kërcimit. Mësuesi i drejton ata nëpër vende në klasë, të shënuara me letërngjitëse

me ngjyra, ku mund të fshihen nga “rraxha”.

Përshkrimi i lojës:

Terri bie u bë vonë, - nxënësit/et ecin nëpër klasë

gaforrja strehë kërkon - gjuhëzohen dhe ecin të strukur nëpër klasë

Niset rraxha dalëngadalë, - ngrihen e ikin nga rraxha

gaforres i del përballë. - imitojnë largimin

Ti gaforre nisu shko, - vrapojnë nëpër klasë

shtëpinë tënde ti kërko. - kërkojnë letër ngjitëse në klasë

(ose diçka që mësuesi zgjedh)

Aty prit ditën e re, - qëndrojnë në vend

e sigurt ti je. - kushdo që ka mbetur pa letër ngjitëse del jashtë loje.

4. Hapi/aktiviteti i katërt: Nxënësit/et shqiptojnë vetë këngën e numërimit dhe ekzekutojnë lëvizjet, derisa ta çojnë lojën në fund.
5. Hapi/aktiviteti i pestë: Nxënësit/et përcjellin incizimin e një fragmenti nga filmi vizatimor ose dëgjojnë shembullin tingullor me muzikë nga i njëjti film, me detyrë që ta njohin (supozimi është se ata tashmë e kanë dëgjuar shembullin më parë dhe do ta njohin). Njohin pjesën muzikore nga filmi vizatimor i Disney Sirena e vogël. Gjatë dëgjimit të dytë nxënësit/et ekzekutojnë lëvizjet duke lëvizur lirshëm në klasë. Me ndihmën dhe mbështetjen e mësuesit, mund të mësojnë dhe të performojnë një koreografi të thjeshtë. Pasi ta kenë dëgjuar këngën dhe performuar koreografinë, mësuesi i bën pyetje nxënësve për t'i nxitur që të arrijnë në përfundimin se kënga sugjeron për lojën dhe vallëzimin.

***Shënim:** Përpara se të fillojë ora, mësuesi vendos letër ngjitëse të dukshme (ose ndonjë tjetër shenjë) që do të përfaqësojë vendstrehime të fshehta për “gaforret” nga “rraxha” (Koreografia mundet të interpretohet gjatë shfaqjes/festimit në klasë).

4.

NJOHIM INSTRUMENTE

Piano

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimit, nxënësi/ja do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të emërtojë në mënyrë vizuale dhe tingullore ngjyrën e tingullit të pianos,
- të përshkruajë me fjalët të veta karakterin e kompozimeve të ndryshme,
- të njohë me anë të dëgjimit shembujt muzikorë,
- të vërejë tempin (shpejt-ngadalë).

Incizime: shembulli për lahutë

R. Shuman, *Kalorësi i egër*

L. van Bethoven, *Për Elizën*

Ecuria e orës

1. Hapi/aktiviteti i parë: Nxënësit/et dëgjojnë një shembull audio me detyrë që të njohin instrumentin (lahuta). Kur ta kenë dalluar/njohur instrumentin, mësuesi shpjegon se përveç veglave/instrumenteve popullore ka edhe instrumente artistike.
2. Hapi/aktiviteti i dytë: Nxënësit/et dëgjojnë kompozimin e R. Shuman *Kalorësi i egër*, me detyrë që të njohin instrumentin që dëgjojnë (piano). Kur ta kenë njohur/dalluar me anë të dëgjimit instrumentin, shikojnë ilustrimin në tekstin mësimor (nëse klasa është e pajisur me TV dhe ka internet, mësuesi mund të lëshojë video incizimin për ta përvetësuar më mirë dhe më plot informacionin) dhe e përshkruajnë atë. Vënë re pozicionin ulur të interpretimit, tastet e bardha dhe të zeza dhe duke luajtur/interpretuar me të gjithë dhjetë gishtat, kurse mësuesi i plotëson përgjigjet e tyre.
3. Hapi/aktiviteti i tretë: Nxënësit/et dëgjojnë sërish kompozimin e R. Shuman *Kalorësi i egër*, me detyrë që të njohin dhe përshkruajnë shpejtësinë e interpretimit të këtij kompozimi (shpejt dhe fuqishëm).
4. Hapi/aktiviteti i katërt: Nxënësit/et dëgjojnë kompozimin e L. van Bethoven *Për Elizën*, dhe dallojnë se edhe në këtë kompozim dëgjojnë pianon. Mësuesi i tyre i inkurajon ta krahasojnë

këtë kompozim me atë të Shumanit dhe vërejnë ndryshimin në shpejtësi të interpretimeve të shembujve që kanë dëgjuar. Nxënësit/et përshkruajnë tempin e shpejtë në shembullin e parë, përballë atij të ngadalshëm (qetë) në shembullin e dytë.

5. Hapi/aktiviteti i pestë: Nxënësit/et kryejnë detyrën në tekstin mësimor (faqe 37) dhe më pas përjetimin e veprave të dëgjuara e ilustrojnë në regjistrin/ditarin për dëgjime.

Trumbeta

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimimit, nxënësi/ja do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të emërtojë në mënyrë vizuale dhe me dëgjim ngjyrën e tingullit,
- të diskutojë arsyet e shumta të shfaqjes së muzikës në kontekste të ndryshme, disa nga zhanret e muzikës (muzikës solemne),
- të përshkruajë me fjalët e veta karakterin e kompozimeve të ndryshme.

Incizime: P. I. Çajkovski, *Kënga napolitane* nga baleti *Liqeni i mjellmave*

Xh. Verdi, *Marshi triumfal* nga opera *Aida*

Ecuria e orës

1. Hapi/aktiviteti i parë: Nxënësit/et dëgjojnë shembullin muzikor (instrumenti i njohur) dhe dallojnë pianon. Diskutojnë për strukturën e pianos.
2. Hapi/aktiviteti i dytë: Nxënësit/et dëgjojnë kompozimin e P. I. Çajkovski *Kënga napolitane* nga baleti *Liqeni i mjellmave*. Mësuesi i udhëzon të vënë re instrumentin që bie në sy në shembull. Ai u tregon disa ilustrime instrumentesh (piano, violinë, trumbetë/bori), dhe nxënësit vijnë në përfundimin se dëgjohet trumbeta.
3. Hapi/aktiviteti i tretë: Nxënësit/et dëgjojnë kompozimin e Xhuzeppe Verdit *Marshi triumfal* (fragment) nga opera *Aida* dhe vënë re se edhe në këtë shembull dëgjohet trumbeta. Gjatë dëgjimit të dytë, nxënësit/et kanë për detyrë të interpretojnë hapat-lëvizjet sipas përjetimeve dhe ndjenjave të tyre; shumica e tyre do të fillojë me hapa (ose mësuesi i rreshton); nxënësit/et njohin marshin ose ecjen me hap të rregullt. Ata vënë re dhe e përshkruajnë me fjalët e tyre atmosferën festive në vepër, si dhe faktin që tingulli i trumbetës është i fortë dhe depërtues.
4. Hapi/aktiviteti i katërt: Nxënësit/et bëjnë detyrën në tekstin mësimor (faqe 37), dhe më pas ilustrojnë përvojën e tyre për veprat që dëgjuan në ditarin e dëgjimeve.

Violina

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimi, nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të emërtojë në mënyrë vizuale dhe me dëgjim ngjyrën e tingullit të violinës,
- të njohë/të dallojë përmes dëgjimit shembujt muzikorë të sugjeruar.

Incizime: N. Paganini, *Kapriço* nr. 24

Koleksionet e Walt Disney, *Relaxing violin classics* (përzgjedhja)³

Ecuria e orës

1. Hapi/aktiviteti i parë: Nxënësit/et përsërisin njohuritë e tyre të arritura për pianon e trumbetën dhe përmendin pjesët e instrumenteve që kanë mësuar. Diskutojnë për rrugën e përfitimit të tonit (imitojnë luajtjen nëpër taste dhe të fryrit në trumbetë/bori). Ata gjithashtu përmendin edhe disa mënyra të përfitimit të tonit në instrumente (imitojnë përfitimin e tonit të instrumentet me hark, instrumentet me dridhëse dhe të instrumentet me goditje).
2. Hapi/aktiviteti i dytë: Nxënësit/et dëgjojnë kompozimin e N. Paganinit *Kapriço* nr. 24, me detyrë që të njohin instrumentin që po luajnë. Kur e kanë njohur violinën, mësuesi u lëshon video incizimin në mënyrë që të shohin se si duket instrumenti dhe si përftohet toni. Nxënësit/et përshkruajnë instrumentin. Ata gjithashtu e kuptojnë se tingulli i violinës është i lartë, i fortë dhe shpues.
3. Hapi/aktiviteti i tretë: Nxënësit/et dëgjojnë shembullin tingullor nga Koleksioni Walt Disney, *Relaxing violin classics* (përzgjedhja), dhe mësuesi u thotë atyre që të dallojnë se tingulli i violinës në këtë shembull është i butë, qetësues, këndues.
4. Hapi/aktiviteti i katërt: Nxënësit/et e kryejnë detyrën muzikore në tekstin mësimor (faqe 39), dhe më pas ilustronë përvojën e tyre për veprat që dëgjuan në ditarin e dëgjimeve.

3 Burimi: YouTube

5. MUZIKËN E NDJEJMË

Babi

(N. Zaimoviq-Xhakoviq)

5

E tri - shtu - ar jam kur ba - bi nuk është k'tu.
Ja - ko tu - žna sam kad ta - ta ni - je tu.

9

Me - zi pres ta shoh, të lu'j si di - kur.
Je - dva çe - kam te i - gre od pri - je.

13

Se - pse ba - bi im është shum', shum' i mir'.
Jer taj ta - ta moj mno - go do - bar je.

17

Me ba - bin as - gjë nuk është e vë - shtir'.
Sa njim baš ni - šta te - ško ni - je.

21

Por kur kthe - het në shtë - pi, do fi - llo - jë një ma - gi.
Kad kod ku - çe bu - de on, tad će bi - ti ma - gi - ja.

Ba - bi im, ba - bi im, si - no - ni - mi për gë - zim.
Ta - ta moj ta - ta moj, to je sre - ça o - ho - hoj!

Rezultatet e të nxënit:

Gjatë mësimi, nxënësi/ja do të jetë në gjendje:

- të këndojë këngë popullore dhe artistike,
- të krijojë përcjelljen e thjeshtë ritmike për këngët e mësuara.

Incizimi: kënga artistike *Babi*

Ecuria e orës

1. Hapi/aktiviteti i parë: Nxënësit/et këndojnë këngë të njohura.
2. Hapi/aktiviteti i dytë: Nxënësit/et diskutojnë për ndjenjat, familjen, zakonet/shprehjet në familje, për prindërit. Gjatë bashkëbisedimit nxënësit flasin për dashurinë për babanë dhe nënën e tyre dhe se si ndihen kur njëri nga prindërit e tyre udhëton diku (p. sh. për punë). Mësuesi shpjegon se kënga *Babi* flet për ndjenjat e një vajze ndaj babait të saj.
3. Hapi/aktiviteti i tretë: Nxënësit/et shikojnë ilustrimin në tekstin mësimor. Mësuesi u shpjegon se kënga është shkruar në gjuhën shqipe dhe më pas e lexojnë njëherë. Viojnë hapat metodikë për përpunimin e këngës sipas veshit.
4. Hapi/aktiviteti i katërt: Pasi kanë mësuar këngën, nxënësit krijojnë dhe ekzekutojnë lëvizjet ritmike (përplasnin duart, kërcasin gishtat, me këmbë godasin në dysHEME).

Muzika dhe ndjenjat 1

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimit, nxënësi do të jetë në gjendje:

- të tregojë/përshkruajë ndjenjat personale në bazë të dëgjimit të veprave muzikore,
- të përdorë vizatime, lëvizje ose shpreh mendimet personale, imazhet dhe ndjenjat,
- të tregojë gatishmëri për të ndarë përvojën e tij/saj me të tjerët në bazë të dëgjimit të veprave muzikore.

Incizime:

- Xhon Villiams, temë nga filmi *Peshkaqeni*
- Frederik Shopen, *Nokturni në b mol*
- Nikollai Rimski-Korsakov, *Fluturimi i brumbullit*
- Tema nga filmi i animuar *Mbreti Iuan* (Karl Xhenkins – Adiemus)

Ecuria e orës

1. Hapi/aktiviteti i parë: Nxënësit/et përsërisin këngën e numërimit Ditë me diell. Diskutojnë për ndjenjat dhe i përshkruajnë ato, duke deklaruar ndjenja që janë më të njohura dhe më të rëndësishme për ta, dhe çfarë ndikon gjithçka rreth nesh për ato. Mësuesi shpjegon se edhe muzika mund të ndikojë në ndjenjat tona, kështu që mund të na bëjë të lumtur, të trishtuar, të japë motivim kur është e nevojshme ose na përkujton diçka që ka ndodhur, ndonjë ngjarje. Pra, ne na zgjon ndjenja të ndryshme.
2. Hapi/aktiviteti i dytë: Nxënësit/et dëgjojnë katër shembuj të ndryshëm tingullor, dhe më pas tregojnë dhe shprehin ndjenjën që zgjoi tek ta kompozimi i dëgjuar. Në tekstin mësimor në faqen 47 shikojnë ilustrimet dhe ekspozitat e emocioneve të ndryshme (shprehjet e fytyrës së fëmijëve), të cilat duhet t'i lidhin me veprat e dëgjuara. Gjatë dëgjimit, në përputhje me ndjenjën që ngjalli tek ata vepra e dëgjuar, ngrenë emotikonët e përgatitur më parë.*

Ndjenjat e pritura gjatë dëgjimit:

Xhon Villiams - temë nga filmi *Peshkaqeni* (i frikësuar)

Frederik Shopen – *Nokturni në b mol* (i trishtuar)

Nikollai Rimski-Korsakov - *Fluturimi i brumbullit* (me nxitim, nervoz)

Tema nga filmi i animuar *Mbreti Iuan* – Karl Xhenkins, Adieumus (festive-ceremoniale)

(Nuk është e detyrueshme që nxënësit/et të japin përgjigjet e përmendura, sepse gjithkush e përjeton muzikën në mënyrën e vet. Për këtë arsye ne duhet t'u themi nxënësve gjithmonë se nuk ka përgjigje të gabuara kur dëgjoni muzikë).

3. Hapi/aktiviteti i tretë: Nxënësit/et shprehin në ditarin-regjistrin për dëgjim mendimet

personale, imazhet dhe ndjenjat që ata përjetuan gjatë dëgjimit.

4. Hapi/aktiviteti i katërt: Nxënësit/et u tregojnë shokëve/shoqeve punimet/ekspozitën e tyre artistike nga ditari i dëgjimeve dhe më pas përshkruajnë punën e tyre. Mësuesi shpjegon se nuk ka imazhe/punime të gabuara dhe të pasakta.

***Shënim:** Siç thuhet në pjesën hyrëse të manualit, mësuesi do t'u shpjegojë nxënësve se si të bëjnë emotikone, ilustrimet e të cilave janë në faqen 51 të tekstit mësimor. Nxënësit mund t'i bëjnë ato në shtëpi ose, në varësi të rezultatit të të mësuarit, në orët e artit figurativ.

Muzika dhe ndjenjat 2

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimit, nxënësi/ja do të jetë në gjendje:

- të tregojë/përshkruajë ndjenjat personale bazuar në veprat muzikore të dëgjuara,
- të përdorë vizatimet, lëvizjet ose të thotë mendimet personale, imazhet dhe ndjenjat,
- të tregojë gatishmëri për të ndarë me të tjerët përvojën e vet mbi veprat muzikore të dëgjuara.

Incizime:

Xhon Villiams, temë nga filmi *Peshkaqeni**

Kamij Sen-Sans, *Mjellma*

Kamij Sen-Sans, *Antilopa*

Modest Musorgski, *Natë në malin e zhveshur*

Kamij Sen-Sans, *Gomarët*

Ecuria e orës

1. Hapi/aktiviteti i parë: Nxënësit/et dëgjojnë përsëri shembullin muzikor – temë nga filmi *Peshkaqeni*. Ata kujtojnë ndjenjat që përjetuan gjatë dëgjimit të parë (frika, paniku, ankthi...).
2. Hapi/aktiviteti i dytë: Nxënësit/et dëgjojnë katër shembuj tingullorë të ndryshëm dhe më pas në tekstin mësimor në faqen 43 shikojnë ilustrimet dhe paraqitjet e fytyrave të fëmijëve që nuk kanë tipare-vija dhe shprehje. Në përputhshmëri me shembullin e dëgjuar kanë për detyrë të vizatojnë ndjenjën që përjetuan gjatë dëgjimit:
Kamij Sen-Sans, *Mjellma* (i qetë, i butë, relaksues)
Kamij Sen-Sans, *Antilopa* (i shpejtë, i gjallë, plot lëvizje)
Modest Musorgski, *Natë në malin e zhveshur* (i frikshëm, i trembur)
Kamij Sen-Sans, *Gomarët* (qesharak, argëtues)
(Nëse dëshirojnë nxënësit/et mund të përdorin “ndjenjat e emotikoneve” edhe te këta shembuj për dëgjim).
3. Hapi/aktiviteti i tretë: Nxënësit/et shprehin përmes vizatimit në ditarin e dëgjimeve mendimet personale, imazhet dhe ndjenjat që ata përjetuan gjatë dëgjimit.
4. Hapi/aktiviteti i katërt: Nxënësit/et u tregojnë shokëve/shoqeve punimet/ekspozitën e tyre artistike nga ditari i dëgjimeve dhe më pas përshkruajnë punën e tyre. Mësuesi shpjegon se nuk ka imazhe/punime të gabuara dhe të pasakta.

***Shënim:** Kompozimet e përmendura janë vetëm sugjerime, mësuesi mund të zgjedhë vetë ose të përshtatë shembuj të tjerë tingullorë.

6. HAPËSIRA PËR DËGJIMIN E MUZIKËS

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimit, nxënësi/ja do të jetë në gjendje:

- të tregojë/përshkruajë ndjenjat personale në bazë të veprave muzikore të dëgjuara,
- të përshkruajë me fjalët e veta karakterin e kompozimeve të ndryshme.

Incizime:

P. I. Çajkovski, *Valsi i luleve*

E. Grig, *Mëngjesi*

F. List, *Vallja e shkurtabiqëve*

Ecuria e orës

1. Hapi/aktiviteti i parë: Para dëgjimit, mësuesi do t'u tërheqë vëmendjen nxënësve për rëndësinë e dëgjimit të veprave muzikore me kujdes, sepse pas dëgjimit do të diskutojnë për ndjenjat që ngjall tek ata dëgjimi i kompozimeve. Do të përshkruajnë, se në çka i lidh/asocion muzika.
2. Hapi/aktiviteti i dytë: Nxënësit/et dëgjojnë kompozimin e P. I. Çajkovskit *Valsi i luleve*. Pas shembullit të dëgjuar, shpjegojnë se janë ndier këndshëm, muzika ishte e butë, i bënte të kërcejnë. Mësuesi i udhëzon ata që në fund të tekstit të gjejnë fletën ngjitëse që përputhet me shembullin që kanë dëgjuar dhe ta ngjitin në vendin e duhur në tekstin mësimor (supozimi është se shumica e nxënësve do të zgjedhin ilustrimin e duhur me lule; nëse zgjedhin ndonjë tjetër, nuk do të thotë se kanë gabuar, sepse në muzikë nuk ka përgjigje të pasakta, përveç përvojave të ndryshme të përjetimit të muzikës). Mësuesi shkruan në tabelë titullin e kompozimit dhe emrin e kompozitorit, kurse nxënësit/et përshkruajnë pranë ilustrimeve në tekstin mësimor (nëse mësuesi e vlerëson se janë të kualifikuar për një aktivitet të tillë).
3. Hapi/aktiviteti i tretë: Nxënësit/et dëgjojnë kompozimin e E. Grig *Mëngjesi*. Pas dëgjimit përshkruajnë ndjenjat e buta në fillim të kompozimit, pastaj vërejnë se po ndryshon volumi/intensiteti - muzika bëhet më e fortë, nga e cila mund të arrijnë në përfundim se diçka dramatike dhe e bukur po ndodh në të njëjtën kohë. Mësuesi i udhëzon të gjejnë fletën ngjitëse në fund të tekstit mësimor që përputhet me shembullin që kanë dëgjuar dhe e ngjisin në vendin e duhur në tekstin mësimor (supozimi është që shumica e nxënësve do të zgjedhë ilustrimin e duhur në të cilin është lindja e diellit). Mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e kompozimit dhe emrin e kompozitorit, kurse nxënësit/et e përshkruajnë pranë

ilustrimit në tekstin mësimor (nëse mësuesi e vlerëson se ata janë të kualifikuar për atë aktivitet).

4. Hapi/aktiviteti i katërt: Nxënësit/et dëgjojnë kompozimin e F. List *Vallja e shkurtabiqëve*. Pas dëgjimit vërejnë, me ndihmën e mësuesit, se kompozimi është realizuar në piano. Dëgjojnë dhe karakterizojnë tempin e kompozimit (të shpejtë). Mësuesi i nxit të shprehin ndjenjat e tyre me lëvizje, pra nxënësit tregojnë lëvizje të shpejta, të befasishme me duar dhe gishta, dhe thonë se kompozimi më kujton lëvizjen e shpejtë. Mësuesi i udhëzon të gjejnë përgjigjen në fund të tekstit mësimor që ka mbetur një e që korrespondon me kompozimin e dëgjuar, dhe më pas e ngjitin në vendin e duhur në tekstin mësimor. Mësuesi shkruan në tabelë titullin e kompozimit dhe emrin e kompozitorit dhe nxënësit e përshkruajnë pranë ilustrimit në tekstin mësimor (nëse mësuesi vlerëson se janë të kualifikuar për një aktivitet të tillë).

Ditari (regjistri) i dëgjimeve

Ditari i dëgjimeve është segmenti i fundit i tekstit mësimor. Në të janë paraqitur shembuj për dëgjimin e muzikës me titullin e kompozimit dhe emrin e kompozitorit. Gjatë orës, nxënësit/et dëgjojnë shembujt muzikorë dhe me ndihmën e mësuesit i analizojnë ata, vëzhgojnë, përshkruajnë dhe më pas shprehen artistikisht në ditarin e dëgjimeve. Në “kornizën” boshe nxënësit/et me udhëzimet e mësuesit “vizatojnë” ndjenjat dhe përjetimet e veta muzikore.

Ndoshta disa nxënës mund të ndeshen për herë të parë me këtë mënyrë pune, kështu që do të jetë interesante për ta. Mësuesi mund të krijojë një ekspozitë me punime me temë dëgjim muzikor, dhe besojmë se edhe prindërve do t’u duket interesante t’i hedhin një sy veprave të fëmijëve të tyre dhe t’i ruajnë ato.

Kur dëgjoni muzikë, është shumë e rëndësishme të përsërisni dhe theksoni se në muzikë, asnjë përjetim nuk mund të jetë i njëjtë ose i gabuar, kështu që te dëgjimi muzikor nuk ka konkurrencë dhe nxënësit/et mund të krijojnë individualisht imazhet e tyre muzikore.

Shfaqjet e klasës

Siç është thënë në pjesën hyrëse të manualit, një numër i caktuar orësh (sipas programit për lëndën e Kulturës muzikore) është paraparë bashkëpunim me komunitetin-bashkësinë lokale, kurrikula e lirë dhe temat ndërkurrikulare. Për këtë arsye, vendosëm që në manual të përfshihen sugjerimet për shfaqjet në klasë.

Me fëmijët e kësaj moshe, është e mundur të realizohet një numër i madh aktiviteteve të ndryshme. Qëllimi është të përfshihen sa më shumë nxënës/e, t'u zhvillohet dhe forcohet vetëbesimi, koordinimi i lëvizjeve dhe aftësive motorike, ndjenja e kolektivit, rëndësia individuale dhe mbi të gjitha të kontribuojmë që ta duan lëndën e Kulturës muzikore.

Shfaqjet mund të shikohen edhe nga këndvështrimi i një ore shembullore, sepse janë pikërisht treguesit e punës dhe përpjekjes së mësuesve, nxënësve, në mënyrë që me një skenar të mirë-projektuar, ne mund ta konsiderojmë këtë orë/mësim si një shembull të orës shembullore.

Më poshtë janë sugjerimet për ngjarjet/shfaqjet e klasës me tema që përkujtojnë ngjarje/data të rëndësishme.

Temat e shfaqjes:

1. Shfaqja e vjeshtës
2. Programi i Vitit të Ri
3. Dita e gruas – 8 Marsi
4. Dita e shkollës
5. Shfaqja për përfundimin e vitit shkollor

Skenari për performancën-shfaqjen e klasës (mësim publik)

– Qasje ndërdisiplinore ndaj përmbajtjes me theks në të nxënit nga mësimi kooperativ i bashkëmoshatarëve.

Shfaqja u përgatit nga a

ktivit/grupi i mësuesve të klasës së parë të Shkollës Fillore “Branko Bozhoviq” në Podgoricë.

Pjesa e përgjithshme didaktike dhe metodologjike

<i>Shkolla</i>	Shkolla fillore “Branko Bozhoviq”
<i>Viti shkollor</i>	2023/2024
<i>Klasat dhe paralelet</i>	I ₁ , I ₂ , I ₃ , I ₄ , I ₅ , I ₆
<i>Data e mbajtjes</i>	mbajtur më 26 dhjetor 2023
<i>Realizuesit e orës</i>	Mësuesi: Zharko Jankoviq; mësueset: Dragana Erakoviq, Sonjica Marinoviq (zëvendëse Tijana Quzoviq), Sllavica Stevanoviq, Radmilla Vullanoviq, Gordana Drashkoviq; Mësuesit e anglishtes Ranka Vuçeliq dhe Sasha Kestner; edukatorët: Dragana Dutina, Zorica Bojiq dhe Bojana Gjekiq; mësueset e muzikës Aleksandra Filipoviq dhe Millica Matanoviq.
<i>Tema</i>	Nxënësit e klasës së parë, shkolla dhe prindërit

Fushat mësimore, rezultatet edukativo- arsimore të të nxënës	Gjuhë malazeze-serbe, boshnjake, kroate dhe letërsi – Në fund të mësimit/orës nxënësit/et do të mund të aplikojnë në bashkëbisedim parimet themelore të marrëveshjes dialoguese – Gjatë mësimit, nxënësit/et do të jenë në gjendje të demonstrojnë përjetimin e këngëve që kanë mësuar përmendësh në mënyrë recitative dhe shprehëse, dhe të zbatojnë rregullat e sjelljes së mirë kur shprehni urimet. Matematika – Në fund të mësimit/orës nxënësit do të mund të klasifikojnë objektet sipas një nga karakteristikat e tyre; të zbulojnë vetinë me të cilën janë renditur objektet dhe për të krahasuar ku ka më shumë/më pak artikuj. – Gjatë mësimit nxënësit do të jenë në gjendje të numërojnë sa objekte ka në grup dhe atë shumë ta shënojnë me numër. Natyra dhe shoqëria – Në fund të mësimit/orës nxënësit do të mund të paraqesin data të rëndësishme dhe ngjarjet në familjen e tyre dhe të thonë kushtet për ruajtjen e shëndetit. – Gjatë procesit mësimor nxënësit/et do të mund të emërtojnë ditët e vitit që janë veçanërisht të rëndësishme, sepse njerëzit u kanë dhënë atyre një rëndësi të veçantë Arti figurativ – Në fund të mësimit/orës nxënësit/et do të mund të përshkruajnë objekte dekorative për rregullimi e ambientit. – Gjatë procesit mësimor nxënësit do të mund të bëjnë disa objekte dekorative në ambientin e punës. Edukimi fizik – Në fund të mësimit/orës nxënësit do të jenë në gjendje të kryejnë lëvizje të thjeshta me shoqërim të muzikës dhe të zhvillojnë ndjenjën e përkatësisë në grup. – Gjatë mësimit, nxënësit/et do të mund të praktikojnë vallëzimin e fëmijëve dhe të fitojnë lëvizje bazë dhe përvojat mbi të cilat mund të ndërtohen njohurit e ndryshme. Kultura muzikore – Në fund të mësimit nxënësit/et do të mund të realizojnë lojëra/vallëzime muzikore dhe të këndojnë qartë dhe shprehimisht këngë popullore dhe artistike. – Gjatë mësimit nxënësit/et do të jenë në gjendje që përjetimet muzikore t'i shprehin në mënyrë kreative me lëvizje; këndojnë këngë popullore dhe artistike në vëllim të përshtatshëm, përmbajtja e të cilit nxit imagjinatën, kërcimin/vallëzimin dhe lojën.
---	--

<i>Metodat mësimore</i>	Interpretuese-krijuese; të mësuarit përmes zbulimit; të nxënës/mësuarit bashkëpunues (edukimi i bashkëmoshatarëve); monolog-dialog; analitike-sintetike; verbale-tekstuale; ilustrativo-demonstrativ.
<i>Format e punës</i>	Frontale; individuale; punë në grupe dhe në çift.
<i>Mjetet mësimore dhe materiali didaktik</i>	CD plejer; CD me muzikë; qendra e zërit/fonia; letrat hamer; kostumet për shfaqje; ëmbëlsirat
<i>Korrelacioni</i>	Gjuhë malazezo-serbe, boshnjake, kroate dhe letërsi (tekstet poetike dhe dramatike); Matematikë (numrat deri në 20); Natyrë dhe shoqëri (festimi i festave); Kultura muzikore (të kënduarit dhe vallëzimi); Edukim fizik (lëvizje me shoqërim muzikor); Arti figurativ (bërja e materialeve dhe maskave për shfaqje/performance).

STRUKTURA E ORËS

<i>Evokimi</i>	Hapi i parë – Nxënësi/ja (drejtuesit e programit) përshëndesin të gjithë të pranishmit me një mirëseardhje të shkurtër
<i>Kuptimi i domethënies</i>	Hapi i parë – Nxënësit prezantojnë programin interesant dhe me përmbajtje që kanë përgatitur në orët e mëparshme (shtojca numër 1) – Recitimi shprehës – Këndimi koral dhe solo – Dramatizimi dhe aktrimi – Interpretimi i koreografisë
<i>Reflektimi</i>	Hapi i parë – Nxënësit me interpretimin koral të këngës së Vitit të Ri urojnë të pranishmëve festa e ardhshme, kurse Babagjyshi (nxënësi me kostum) shpërndan ëmbëlsira.

<i>Rishikimi i realizimit</i>	– Të gjitha rezultatet e parashikuara janë realizuar plotësisht.
Vërejtje!	– Nxënësit/et së bashku me mësuesin, edukatoren dhe arsimtarët kanë përgatitur një program nga fusha të ndryshme në orët e rregullta të mbajtura më parë. Të gjithë nxënësit e klasës së parë morën pjesë dhe përfaqësuan përmbajtjet e mësuara. Për shkak të numrit të madh të nxënësve dhe pikave të përgatitura, programi është i ndarë në dy pjesë: Pjesa e parë – nxënësit e klasave I ₁ , I ₂ , I ₃ dhe pjesa e dytë – nxënësit e klasave I ₄ , I ₅ , I ₆ .

Shtojca numër 1 – PROGRAMI

Pjesa e parë

1. *Mirëseardhje* – recitim dhe kor – I₁
2. *Mirë se vini fillestarë* – recitim – I₂
3. *Unë jam unë* – recitim – I₃ dhe I₄
4. *Unë dhe ti* – ritmikë – I₂
5. *Mësuesja dhe Perica* – skeç – I₂
6. *Betimi i nxënësit të ri* – recitim
7. *Shkolla* – kor dhe solo këndim – I₁
8. *Shkolla nuk është ndërtesë* – recitim – I₃
9. *Kubi është i shtrembër* – lojë – I₃
10. *Numbers* – ritmikë – anglisht – I₁ dhe I₂
11. *Mësojmë të numërojmë* – ritmikë – I₁, I₃
12. *Dashuria* – lojë – I₂
13. *Vjeshta është fajtorë* – recitim – I₃
14. *Dymbëdhjetë vëllezërit* – recitim – I₃
15. *Borëbardhi* – skeç – I₂
16. *Na i shpëto zogjtë o dimër* – recitim – I₂
17. *Macja në pantofla* – dramatizimi i tekstit – I₂
18. *Dashuria le të shkëlqejë kudo* – kori (Aleksandra Filipoviq)
19. *Letër Babadimrit* – lojë – I₂
20. *Letër prindërve* – lojë – I₃
21. *Family* – performancë vokale – I₃
22. *Prindërve të fillestarëve* – recitim – I₁
23. *Urimet e Vitit të Ri* – kor – I₁, I₂, I₃

Pjesa e dytë

1. *Mirë se vini* – recitim – I₅
2. *Përshëndetje* – skeç – I₆
3. *Çfarë është shkolla?* – recitim – I₅
4. *Pëshpëritje* – ritmikë – I₅
5. *Mirëmëngjesi, shkollë* – recitim – I₅
6. *Mizë dheu* – ritmikë – I₆
7. *Forma gjeometrike* – skeç – I₅
8. *Fjalë magjike* – skeç – I₄
9. *Fjollat e borës* – skeç – I₅
10. *Të shoqërohem* – kor – I₆
11. *Kësulëkuqja* – skeç – I₄
12. *Recital i Vitit të Ri* – recitim – I₄
13. *Babadimër, ku të çojnë shtigjet me borë* – kor (Milica Matanoviq)
14. *Recital i Vitit të Ri* – recitim – I₄
15. *Babadimër, mos u largo nga rruga* – ritmikë – I₅
16. *Fëmijët dhe babadimri* – ritmikë – I₄
17. *Në shkronjë, në shkronjë* – recitim – I₆
18. *Urime për Vitin e Ri* – I₆
19. *Viti i Ri troket* – kori (Milica Matanoviq)
20. *Dëshirat e Vitit të Ri* – kor – I₄, I₅, I₆

Rekomandime për qasjen dhe punën me fëmijët me nevoja të veçanta arsimore dhe fëmijët e talentuar

Në vitet '90 të shekullit XX Mali i Zi e kuptoi nevojën për të futur orientimin inkluziv/gjithëpërfshirës për fëmijët me pengesa dhe vështirësi në zhvillim – me nevoja të veçanta arsimore. Si zgjedhje e parë dhe e domosdoshme, ndjekin kopshtet dhe shkollat e rregullta (arsim inkluziv-gjithëpërfshirës).

Fëmijët me nevoja të veçanta arsimore janë:

- fëmijët me të meta në zhvillim – fëmijët me të meta fizike, intelektuale, me çrregullime shqisore, fëmijë me çrregullime të kombinuara dhe çrregullime të spektrit të autizmit;
- fëmijët me vështirësi zhvillimi – fëmijët me vështirësi në të folurit e gjuhës, çrregullime të sjelljes, sëmundje të rënda kronike, fëmijët e sëmurë afatgjatë dhe fëmijët e tjerë që kanë vështirësi në të mësuar dhe vështirësi të tjera të shkaktuara nga pengesat emocionale, sociale, gjuhësore dhe kulturore.

Thelbi i punës është Programi Arsimor i Zhvillimit Individual (PAZHI, në gjuhën malazeze IROP). Atyre u përcaktohen qëllimet edukative dhe zhvillimore bazuar në marrëdhëniet aktuale dhe të planifikuara të funksionimit të fëmijës (njohës, emocional, social dhe fizik), nivelet e njohurive dhe aftësive. Përcaktohen format e punës edukativo-arsimore për fushat e edukimit dhe arsimimit, gjegjësisht për lëndët mësimore, mënyra e verifikimit dhe e vlerësimit të arritjeve dhe përparimeve arsimore, dhe zhvillimore në përputhje me aftësitë/mundësitë e tyre individuale. PAZHI mundëson: shkurtimin ose zgjerimin e përmbajtjes së programit lëndor; ndryshimin, përshtatjen dhe individualizimin e metodikës me të cilën realizohen përmbajtjet, plotësohen format alternative të komunikimit, gjuhën e shenjave, shkrimin Braille (Brajl), sistemin e komunikimit përmes imazheve/fotove, përdorimin e didaktikës së specializuar, pajisjeve, mjeteve ndihmëse, teknologjitë ekzistuese etj.

Një nga parimet bazë të përfshirjes në procesin edukativo-arsimor është t'u mundësohen fëmijëve, nxënësve, kushtet për mësim dhe pjesëmarrje në aktivitete që kontribuojnë në zhvillimin e tyre të përgjithshëm, por edhe të potencialeve muzikore. Pjesëmarrja në aktivitete muzikore ka ndikim të shumëfishtë sepse inkurajon ndërveprimin, komunikimin, forcimin e fuqive emocionale dhe të maturisë, si dhe kapacitetet njohëse. Reagimet ndaj muzikës nga fëmijët me nevoja të veçanta arsimore varen nga karakteristikat e pengesave të tyre dhe vështirësitë në zhvillim. Prandaj, këto rekomandime sugjerojnë se çfarë përmbajtjesh dhe aktiviteteve muzikore mund të përdorin mësuesit në punën e tyre me këta fëmijë. Nuk ofrohen si zgjidhje të gatshme, por qëllimi është që të frymëzohen duke përdorur parimin e qasjes së individualizuar dhe të gjetjes së një mënyrë më efikase për zhvillimin personal të fëmijës, ose pjesëmarrjen e tij në aktivitetet e bashkëmoshatarëve.

Çdo fëmijë, pavarësisht nga karakteristikat individuale, tipike ose zhvillimet e përcaktuar nga pengesat dhe vështirësitë, duhet parë si një person që ka aftësi dhe potenciale të ruajtura, të cilat mund t'i shpreh veçanërisht përmes muzikës. Nëpërmjet aktiviteteve muzikore të

organizuara, në ndërveprim me bashkëmoshatarët, është e mundur të avancohet dhe nxitet zhvillimi i tyre i përgjithshëm dhe muzikor dhe, brenda kufijve të mundësive të ruajtura, të aftësohen mundësitë e përfshirjes së duhur në segmentet e tjera të arsimit. Që të jetë e suksesshme përfshirja e fëmijëve me pengesa dhe vështirësi në zhvillim, është e nevojshme të krijohet një klimë pozitive në grup, pranimi dhe respektimi i ndërsjellë i fëmijëve dhe i dallimeve që ekzistojnë midis tyre. Konkretisht, muzika dhe aktivitetet muzikore, pavarësisht nga krijimtaria e tyre ose potencialet artistike, bashkojnë fëmijët dhe unifikojnë vëmendjen e tyre, inkurajojnë shoqërimin, ndihmojnë që të socializohen dhe të ndërtojnë vetëdijen për veten e tyre, përkatësinë e grupit, po ashtu shfaqin shprehitë e tyre në mënyrë kreative, rrisin nivelin e tyre të pavarësisë dhe vetëbesimit. Me ndihmën e muzikës, fëmija shquhet/nxitet të marrë pjesë në lojë dhe në mësim sipas mënyrës së tij, sepse në atë mënyrë bëhet pjesëmarrës aktiv ose pjesëmarrës i zhvillimit të vet.

Aktivitete muzikore

Muzika dhe ritmi (si segment i muzikës) mund të aplikohen me sukses në punën me fëmijët me nevoja të veçanta arsimore. Marrëdhënia midis muzikës dhe aktiviteteve e ndonjë individi mund të shërbejë si motivim për komunikim. Për shembull, përdorimi i instrumenteve ritmike të instrumentariumit të Orfit është i dobishëm për ruajtjen e vëmendjes dhe kuptimit të ritmit në muzikë, por edhe i ritmit të fjalës së folur. Fëmijët praktikojnë proceset perceptuese përmes prejës së instrumenteve. Aty zhvillohen stimujt vizualë, dëgjimorë dhe prekës. Përdorimi funksional i gishtërinjve dhe duarve mund të ushtrohen duke përdorur shkopinjë, daullen e vogël, rraketaket ose instrumentin me taste. Gjatë aktiviteteve muzikore, nxënësit/es duhet t'i lejohet komunikim pa pengesë; mësuesi nuk duhet ta nxitojë ose ngadalësojë atë.

Këndimi i këngëve, si aktivitet muzikor, ofron edhe kontakt verbal. Gjatë dëgjimit të muzikës, një reagim i mundshëm që shfaqet tek fëmijët më të vegjël është lëkundje nën muzikë. Prandaj, mësuesi duhet t'ua përshtasë dëgjimin e muzikës dhe gradualisht ndryshimin e tempit dhe dinamikës. Çdo reagim, qoftë edhe negativ, duhet të përdoret për të inkurajuar komunikimin dhe për ta kthyer reagimin negativ në drejtim konstruktiv, eksperimental dhe zhvillimor.

Në terapinë muzikore, po ashtu edhe në mësimin e lëndës së Kulturës muzikore, përdoren metodat receptive/pritëse dhe aktive. Te metoda receptive, nxënësit/et vijnë në kontakt me muzikën përmes dëgjimit, kurse te metodat aktive marrin pjesë në aktivitete muzikore duke kënduar ose luajtur në instrument.

Te qasja receptive, gjatë ose pas dëgjimit muzikor, nxënësit/et, në njëfarë mënyre, mund të reagojnë në atë që kanë dëgjuar: ata thjesht mund të liroheshin plotësisht me muzikë, mund të lëvizin me të e të interpretojnë lëvizje të improvizuara kërcimi. Atyre mund t'u kërkohej që me muzikë dhe biseda, t'u kujtohen përjetimet e tyre ose të shprehin përvojat e tyre të kompozimeve që kanë dëgjuar. Te qasja aktive nxënësit/et luajnë në instrument, improvizojnë, krijojnë këngë të reja dhe këndojnë. Kjo qasje është e mirë për nxënësit/et që kanë vështirësi në komunikimin verbal (për shembull, fëmijët autikë) ose kur dëshironi të ndikoni në zhvillimin e përqendrimit, aftësive sociale e psikomotorike (fëmijët me paralizë cerebrale), gjithashtu është i zbatueshëm në punën edhe me fëmijët e zakonshëm.

Fëmijët me nevoja të veçanta arsimore duhet të lejohen të merren me muzikë për të rritur potencialet e ruajtura dhe për të përmirësuar rritjen dhe zhvillimin personal. Në punën në grup, të gjithë nxënësit/et duhet të përfshihen në këndimin e këngëve, në ekzekutimin e instrumenteve ritmike që prodhojnë tinguj të ndryshëm ose që ekzekutojnë aranzhime instrumentale të thjeshta. Këto në përputhje me pengesën: p. sh. te ata me pengesa intelektuale – melodi të thjeshta; te spektri i autizmit – ato që fëmija i preferon dhe në përputhje me funksionimin perceptues; te dëmtimet e shikimit, të mbështeten në të prekshmen-aktivizimin e përvojës;

te pengesat në dëgjim të mbështeten në vizualizim dhe elemente të kërcimit; te pengesat/çrregullimet fizike të përdorni aktivitete që përfshijnë motorikën e madhe. Gjithashtu mund të marrin pjesë në krijimin ose improvizimin e muzikës, në lojëra/vallëzime, në dramatizime të vogla muzikore dhe nën muzikë të interpretojnë lëvizje/hapa. Muzika do të ketë efekt relaksues tek ta, do t'i inkurajojë ata, si në aktivitete, ashtu edhe në komunikim shoqëror.

Në kuadër të mësimet nga lënda e Kulturës muzikore nxënësi/ja me nevoja të veçanta arsimore mund të: riprodhojë (këndojë, luajë) muzikë, krijojë, improvizojë (ritëm, melodi ose lëvizje sipas ritmit të muzikës) ose të dëgjojë muzikë. Dëgjimi i tingujve nga natyra (shpallja e delfinëve ose e balenave, zhurma e valëve të detit, cicërima e zogjve) si dhe fragmente kompozim të muzikës artistike (nga Moxarti, Vivaldi, Bethoveni, Bahu, Brahmsi, Çajkovski dhe të tjerë) ka efekt të dobishëm. Kështu muzika bëhet ndërvepruese, komunikuese dhe mekanizëm i relaksimit.

Fëmijët me prirje muzikore

Prirja ose dhuntia muzikore është një strukturë vetish që i mundësojnë ndonjë individ që vazhdimisht të arrijë rezultate mbi mesataren në një ose më shumë aktivitete muzikore me të cilat merret. Shpesh me fenomenin e prirjes-dhuntisë muzikore lidhet termi talent, megjithatë të prirur/me dhunti mund të konsiderohen edhe ata që kanë aftësitë e larta muzikore të zhvilluara, kurse talente janë ata që arrijnë arritje të larta në ndonjë aktivitet muzikor. Një nga detyrat e mësuesit është të zhvillojë shkathtësitë për zbulimin/të vënit re dhe “diagnostifikimin e fillestarëve/eve” - nxënësve të prirur për muzikë dhe për të nxitur zhvillimin e potencialit muzikor ekzistues. Fëmijët me prirje muzikore e shijojnë muzikën, kuptojnë më mirë ritmin, mbajnë mend lehtësisht meloditë, kanë një zgjuarsi ndjenjash për lartësi të toneve, kënaqen duke kënduar dhe dëgjuar muzikë. Fëmijëve të tillë duhet t’u ofrohet më shumë mundësi për të ekzekutuar disa pika muzikore, për të dëgjuar lloje të ndryshme muzikore dhe për të dëgjuar tregime rreth muzikës. Sipas mundësive, atyre duhet t’u jepen detyra më kërkuese krahasuar me fëmijët e tjerë në klasë. Prirja-dhuntia muzikore kryesisht trashëgohet nga prindërit, kurse gjenet kontrollojnë qendrat për njohjen e lartësive të toneve në tru. Shkencëtarët/et besojnë se ndikimi gjenetik është kaq i fortë, sa që është pak e besueshme se orët e muzikës do të ndryshojnë muzikalitetin e fëmijës nëse ai është i shprehur dobët ose fëmija nuk e posedon fare.

Aktivitetet muzikore për punë me nxënësit që kanë prirje

Nxënësit/et individualisht ose në çift luajnë lojën *kujtesa me tinguj*. Duhet rreth dhjetë kuti identike që plotësohen në mënyra të ndryshme, por nga dy të barabarta (p. sh. në dy kuti vendosim kokrra fasuleje, në dy të tjera kapëse letre, në dy të tjera guralecë, etj.). Nxënësit/et duhet të dëgjojnë tingujt nga kutitë për të bashkuar dy kuti me të njëjtin tingull.

LITERATURA

- Ambrush-Kish Ruzhica, Janković Ana, Mamić Zhelkica, *Глазбени кључ 1, глазбена почетница за 1. разред основне школе* (Çelësi muzikor 1, fillesat muzikore për klasën e parë të shkollës fillore), Profil Klett sh.p.k. Zagreb
- Vasilević Zorisllava, *Музички буквар* (Abetarja muzikore), Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Beograd, 1991
- Vasilević Miodrag, *Народне мелодије Црне Горе* (Meloditë popullore të Malit të Zi), Instituti i muzikologjisë, Beograd, 1965
- Vujić Branka, Dedić Ivana, Naumovski Aleksandra, *Чудесни свијет звукова 1*, (Bota e mrekullueshme e tingujve 1), Kultura muzikore për klasën e parë të shkollës fillore nëntëvjeçare, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2005
- Vujić Branka, Kostić Sunčica, Gjurishić Snezhana, Naumovski Aleksandra, *Чудесни свијет звукова 2* (Bota e mrekullueshme e tingujve 2), Kultura muzikore për klasën e dytë të shkollës fillore nëntëvjeçare, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2005
- Vučinić Vesna, Perunović-Razhnatović Ana, *Музичке активности у предшколском васпитању и образовању, приручник за васпитаче у предшколским установама* (Aktivitetet muzikore në arsimimin dhe edukimin parashkollor, manuali për edukatore/ë në institucionet parashkollore), Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2019
- Ivanović Nada, *Музика у основној школи* (Muzika në shkollën fillore), Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2008
- Ilić Vlladica, *Музичка култура за први разред основне школе* (Kultura muzikore për klasën e parë të shkollës fillore), Qendra Kreative, Beograd, 2008
- Jabllanov Nada, *Народне песме и игре за децу, родитеље, васпитаче и учитеље* (Këngë dhe vallëzime/lojëra popullore për fëmijë, prindër, edukatorë dhe mësues, botimi i dytë, Qendra Kreative, Beograd, 2006
- Martinović-Bogojević Jellena, Papić Millena, Đurković Bilana, *Чаролија музике 1*, Magjia e muzikës 1, Kultura muzikore për klasën e parë të shkollës fillore nëntëvjeçare, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2013
- Programi mësimor për ciklin e parë të shkollës fillore, Enti për shkollim, Podgoricë, 2009
- Programi mësimor i KULTURËS MUZIKORE për klasat I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII dhe IX të shkollave fillore, Enti për shkollim, Podgoricë, 2017
- Stoković Petar, *Настава музичке културе* (Mësimdhënia e kulturës muzikore), Enti i Teksteve dhe i Mjeteve mësimore, Beograd, 1988